



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 392 Akti

Nr. 554 Vendimi

Tiranë, më 18.7.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Genta Tafa (Bungo)	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 14.7.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Albert Meça**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Albert Meça, aktualisht gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt rivlerësimi që i nënshtrohet procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka hedhur shortin në datën 16.12.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Albert Meça do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Alma Faskaj dhe Lulzim Hamitaj. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Genta Tafa (Bungo).

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 19.12.2019 u caktua me mirëkuptim si kryesues z. Lulzim Hamitaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga dy prej anëtarëve të trupit gjykues, ndërsa relatorja ka paraqitur kërkesën për dorëheqje. Me vendim nr. 2, datë 8.1.2020, të Komisionit, u ngrit trupi gjykues për të marrë në shqyrtim këtë kërkesë. Me vendimin e datës 16.1.2020, ky trup gjykues, pasi ka vlerësuar rrethanat dhe faktet, ka vendosur mospranimin e kërkesës së bërë nga komisionere Genta Tafa (Bungo). Në këto kushte, relatorja e çështjes ka administruar dokumentacionin përkatës dhe ka filluar hetimin administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Albert Meça.

5. Me vendim nr. 11, datë 10.5.2022, të Komisionit, u zëvendësua me short komisionerja Alma Faskaj, për shkak të mungesës për arsye shëndetësore. Komisionere zëvendësuese u zgjodh znj. Pamela Qirko, e cila deklaroi menjëherë mungesën e konfliktit të interesit.

6. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Albert Meça, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

7. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

8. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

9. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

10. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë

administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

11. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Albert Meça. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- a) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor dhe mungesë e burimeve financiare për të justifikuar pasuritë;*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

12. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin² e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Albert Meça.

13. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

14. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: atë të vlerësimit të pasurisë; të kontrollit të figurës; dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

15. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 22.6.2022, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Albert Meça; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

16. Subjekti i rivlerësimit, në datën 22.6.2022, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 23.6.2022 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 7.7.2022.

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 14.9.2018.

² Raporti nr. *** prot., datë 31.10.2017.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.10.2021.

17. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁴.

II. SEANCA DËGJIMORE

18. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail* në datën 12.7.2022.

19. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 14.7.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma.

20. Subjekti i rivlerësimit, z. Albert Meça, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Albert Meça kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

21. Z. Albert Meça ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

21.1. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

22. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

23. Referuar vendimit nr. 2/2017⁵ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c)

⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 12.7.2022.

⁵ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i papabuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

“Deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; si dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

25. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 24.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

26. Apartament⁶ me sipërfaqe 105 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, rruga “M.Gj” (sot S. D) Tiranë, me vlerë 45,000 euro, blerë më 2.4.2004, në të cilën subjekti zotëron 100 % (në bashkëpronësi me bashkëshorten M.M).

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhura nga paga e subjektit dhe bashkëshortes M.M.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- Subjekti, në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë të vitit 2004, ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit kredi, huamarrje dhe dhuratë, kurse në deklaratën e pasurisë *Vetting* ka deklaruar si burim financiar të ardhurat nga paga e tij dhe të bashkëshortes.
- Rezulton se pagesa në vlerën 45,000 euro për blerjen e apartamentit është likuiduar në datën 2.4.2004, kurse kredia në Bankën Italo-Shqiptare, në vlerën 20,000 euro, është marrë në datën 28.4.2004. Rrjedhimisht, ka mungesë burimi të ligjshëm financiar për blerjen e apartamentit në vlerën 45,000 euro.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar në vitin 2004 për huamarrjen në vlerën 10,000 euro dhe dhuratën në vlerën 600,000 lekë, të përdorura për blerjen e apartamentit në vlerën 45,000 euro.

Hetimi⁷ dhe arsyetimi juridiko-financiar i kryer nga Komisioni

⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) vërtetim hipotekor nr. ***, datë 6.4.2004; (ii) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 2.4.2004.; (iii) shkresë nr. ***, datë 18.12.2017, të ZVRPP-së.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2020, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 1.4.2020, e ASHK-së Tirana Jug; shkresë nr. *** prot., datë 16.11.2021, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.12.2021, e ASHK-së Tirana Jug; shkresë nr. *** prot., datë 22.1.2020, drejtuar OSHEE-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.1.2020, e FSHU-së; shkresë nr. *** prot., datë 22.1.2020, drejtuar UKT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. K-*** prot., datë 5.2.2020, e UKT-së; shkresë nr. *** prot., datë 9.12.2021, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.12.2021, e ASHK-së Tirana Jug.

26.1. Subjekti, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 2.4.2004, ka blerë apartament me sip. 105 m², të ndodhur në rrugën “M.Gj”, Tiranë, me vlerë 45,000 euro⁸, e cila deklarohet e shlyer jashtë zyrës noteriale, përpara redaktimit të kontratës së shitjes.

26.2. Bazuar në vërtetimin hipotekor nr. ***, datë 6.4.2004, të dorëzuar nga subjekti së bashku me deklaratën *Vetting*, apartamenti rezultoi i regjistruar pa numërtim pasurie, por identifikohet me apartament nr. *** në katin e gjashtë të godinës shtatëkatëshe. Referuar kartelës së pasurisë gjeneruar nga sistemi elektronik i ASHK-së⁹, apartamenti është regjistruar me numër pasurie ***.

26.3. Në pyetësin standard në lidhje me këtë apartament, si dhe me mobilimin e tij, subjekti ka deklaruar se shpenzimet e mobilimit të apartamentit janë afërsisht 1,000,000 lekë, pasi një pjesë e pajisjeve nuk janë hequr nga shitësi. Në pyetësin e datës 4.3.2022 subjekti ka qartësuar periudhat e kryerjes së shpenzimeve të mobilimit për këtë apartament.

27. Komisioni ka hetuar në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, duke marrë në konsideratë deklarinimin e subjektit në deklaratën *Vetting*, si dhe deklarinimet periodike.

27.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti deklaron se burim i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

27.2. Nga verifikimi i DPV-ve rezultoi se subjekti e ka deklaruar këtë apartament në DPV/2004, me përshkrimin “Apartament banimi në rr. ‘M.Gj’ nr. ***, Tiranë, sip. 105 m², ndërtuar në vitin 1997, me vlerë 45,000 euro dhe datë krijimi 2.4.2004”.

Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” subjekti, gjithashtu, ka deklaruar:

- kredi në vlerën 20,000 euro, akorduar nga Banka Italo-Shqiptare (sot “Intesa Sanpaolo Bank”), sipas kontratës së kredisë datë 28.4.2004, me afat 72 muaj, me qëllim blerje apartamenti;
- detyrim financiar 10,000 euro ndaj vëllait E.M, me qëllim blerje apartamenti, shlyer vlera prej 4,000 euro deri në dhjetor të vitit 2004.

27.3. Në përgjigje të pyetësit standard si burim për blerjen e apartamentit subjekti ka deklaruar: huan e marrë nga shtetasi E.M në vlerën 10,000 euro; huan e marrë nga shtetasi Z. Ç në vlerën 20,000 euro; të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

Në këtë pyetësor, në përgjigje të pyetjes lidhur me huamarrjet e mundshme ndaj personave të tretë, subjekti ka deklaruar: *“Në muajin mars 2004 i kam marr borxh shumën 10,000 euro shtetasit E.M, i cili është vëllai im. Shumën e mësipërme vëllai e ka siguruar nga puna e tij në Itali dhe e ka sjellë në periudha të ndryshme në Shqipëri në banesën e prindërve. Kjo shumë më është dorëzuar nga babai, pasi vëllai në atë kohë ndodhej në Itali. Për shkak të marrëdhënies së posaçme dhe besimit reciprok nuk kemi hartuar akt të shkruar. Borxhi i mësipërm është shlyer plotësisht nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes në vitet 2004 - 2005, sikurse është pasqyruar në deklaratat periodike të pasurisë.*

Në muajin mars 2004 i kam marr borxh shtetasit Z.Ç shumën 20,000 euro. Shtetasi i mësipërm është daja im, vëllai i nënës time M.M. Shuma e mësipërme është siguruar nga biznesi i dajës tim, shoqëria ‘E’ sh.p.k., që ushtron aktivitetin që prej vitit 1994 dhe kursime apo të ardhura të familjes së tij. Borxhi i mësipërm është marrë vetëm për një periudhë shumë të shkurtër kohore dhe me kusht që të shlyhej sapo të merrej kredia bankar. Nuk kemi hartuar akte të shkruara pasi marrëdhënia jonë ishte e posaçme, koha e shkurtër e marrjes dhe shlyerjes, si

⁸ Shitësi rezultoi ta ketë blerë këtë apartamentin përmes kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 14.8.1999, të lidhur me shoqërinë “A” sh.p.k., me çmim shitblerjeje 40,000 USD.

⁹ Kartelë e gjeneruar në datën 7.12.2021 nga sistemi elektronik i ASHK-së.

edhe të besimit reciprok midis nesh dhe familjeve tona. Borxhi është shlyer i gjithi me kredinë e marrë nga Banka Italo-Shqiptare (sot Intesa Sanpaolo Bank) në muajin maj 2004”.

27.4. Subjektit i janë kërkuar shpjegime në lidhje me deklarinimin e burimeve të ndryshme në deklaratën Vetting dhe DPV/2004, ku në përgjigje të pyetësorit datë 4.3.2022, ka sqaruar: *“Duke pasur parasysh se në vitin e dorëzimit të deklaratës Vetting të vitit 2017, si detyrimet që vinin nga kredia bankare, edhe pagesa e borxhit të vëllait tim, ishin përmbushur edhe si burim për përmbushjen e këtyre detyrimeve që lidhen me krijimin e pasurisë, kanë shërbyer të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes M.M, në deklaratën Vetting është deklaruar se burimi i krijimit të pasurisë janë të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes. Përderisa në vitin 2017 (data e dorëzimit të deklaratës Vetting) ishin shlyer të gjitha detyrimet, burimi i blerjes së apartamentit janë të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes M.M, pasi me to janë shlyer borxhet apo kreditë. Procedura dhe dinamika e blerjes së apartamentit, pagesave dhe shlyerjes së detyrimeve janë deklaruar në DPV sipas viteve përkatëse”.*

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se ka mospërputhje midis deklarimeve të tij në deklaratën Vetting dhe në DPV/2004 në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie.

27.5. Referuar deklarimeve të mësipërme të subjektit, Komisioni ka konsideruar dhe analizuar si burime të krijimit të kësaj pasurie:

- a) huan në vlerën 10,000 euro marrë nga shtetasi E.M;
- b) huan në vlerën 20,000 euro marrë nga shtetasi Z.Ç, si dhe kredinë e marrë për shlyerjen e kësaj huaje, e cila në vetvete duket se përbën burim të kësaj pasurie (duke marrë në konsideratë faktin se kredia e pretenduar si burim në DPV/2004 ka shërbyer për shlyerjen e huas ndaj shtetasit Z.Ç, si dhe faktin që kjo kredi është disbursuar pas datës së lidhjes së kontratës së shitjes, Komisioni e ka analizuar këtë kredi në cilësinë e “burimeve” të përdorura për blerjen e apartamentit);
- c) të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes deri në momentin e blerjes së apartamentit.

28. Hua e marrë në vlerën 10,000 euro në mars të vitit 2004 nga shtetasi E.M

28.1. Për të vërtetuar të ardhurat e ligjshme të shtetasit E.M, të cilat kanë shërbyer si burim për dhënien e huas, subjekti i ka bashkëlidhur pyetësorit standard dhe pyetësorit datë 4.3.2022 dokumentacionin e mëposhtëm:

- librezë pune nr. *** regjistri, për z. E.M, lëshuar nga Ministria e Punës dhe e Ndhmës Sociale, Inspektorati i Punës Itali;
- letër për marrje në punë nga kompania italiane “S” spa, datë 7.7.2003;
- deklaratë e kompanisë italiane “S” spa, datë 4.11.2004, përmes së cilës konfirmohet vijueshmëria e punësimit të shtetasit E.M pranë kësaj kompanie, deri në datën e lëshimit të deklaratës;
- vërtetim llogari page nga “B.P.A”, datë 14.2.2005, ku deklarohej se në llogarinë e shtetasit E.M pranë kësaj banke kreditohet çdo muaj paga e tij në kompaninë “S” spa;
- deklarinim i të ardhurave të shtetasit E.M për vitet 2001 - 2002, si dhe deklarinimet e pagave mujore për këtë periudhë kohore;
- ekstrakt i llogarisë së sigurimeve nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore Itali, lëshuar në datën 13.1.2021 nga Komuna San Severino Marche, Itali¹⁰, ku pasqyrohen të ardhurat e përfituara nga shtetasi E.M nga pagat për periudhën 1.9.2001 - 10.5.2007;
- kopje të faqes së pasaportës të shtetasit E.M, ku evidentohen vulat hyrëse dhe dalëse nga Shqipëria, për periudhën 2004 – 2005;

¹⁰ Dokument i pajisur me vulë apostile, por i pa përkthyer në gjuhën shqipe.

- vizë pune në emër të shtetasit E.M në Itali.

28.2. Subjekti i ka bashkëlidhur pyetësorit standard deklaratën noteriale nr. ***, datë 3.2.2020, të shtetasit E.M, përmes së cilës deklaroi: *“Në fillim të vitit 2004 i kam dhënë hua vëllait tim Albert Meça shumën prej 10,000 euro. Burimi i kësaj shume është nga puna ime në Itali si punëtor i shoqërisë ‘S’ spa për të cilën disponoj edhe dokumentacionin e nevojshëm. Kjo shumë është sjellë nga ana ime gjatë vizitave që kam bërë në Shqipëri dhe ka qenë e depozituar në banesën e babait tim F.M, ku jetoj edhe unë. Ajo i është dorëzuar vëllait tim nga babai im. Në lidhje me këtë borxh, nuk kemi hartuar akte me shkrim për shkak të marrëdhënies vëllazërore dhe mirëbesimit reciprok. Borxhi i mësipërm më është shlyer tërësisht brenda dy viteve dhe nuk kam asnjë pretendim”.*

28.3. Analizë financiare

Bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, në analizë financiare janë përfshirë:

- të ardhura nga punësimi i huadhënësit E.M në shtetin italian;
- shpenzimet jetike janë llogaritur për një person.

Referuar *EuroStat*, për shtetin italian, shpenzimet jetike të përlllogaritura mbi pagën mesatare për vitin 2001 janë 6,240 euro dhe për vitin 2004 janë 8,179 euro.

Për një njësim të përlllogaritjes së shpenzimeve jetike në analizë është konsideruar mesatarja e normës së aplikuar për vitet 2001 dhe 2004, e cila rezulton të jetë 66.79% për të gjithë periudhën.

Metodologjia e përdorur është ajo kumulative, pasi huadhënësi nuk është subjekt i deklaramit periodik të pasurisë.

Tabela nr. 1.¹¹

Analiza financiare në euro	Viti 2001	Viti 2002	Viti 2003	Datë 6.4.2004
Të ardhura	2,940.19	11,465.20	10,162.27	3,253.85
Shpenzime jetike ¹²	1,940.53	7,567.03	6,707.10	1,585.33
Mundësia për kursime kumulative	999.66	4,897.83	8,353.00	10,021.52

Nga analiza financiare duket se shtetasi E.M ka pasur mundësi financiare për dhënien e huas subjektit në shumën 10,000 euro.

28.4. Në lidhje me shlyerjen e detyrimit ndaj shtetasit E.M, subjekti ka kryer deklaramet e mëposhtme në DPV-të periodike:

- në DPV/2004 subjekti ka deklaruar shlyerjen e vlerës 4,000 euro;
- në DPV/2005 subjekti ka deklaruar shlyerjen e vlerës 6,000 euro.

28.5. Në përgjigje të pyetësorit datë 4.3.2022, në lidhje me shlyerjen e këtij detyrimi, subjekti ka deklaruar: *“Shlyerja e huas/borxhit ndaj vëllait tim E.M është kryer me të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes M.M nga paga, shpërblime, pjesëmarrje në komisione, si dhe aktivitete dhe trajnime jashtë Shqipërisë. Të ardhurat e mësipërme dhe pagimi/shlyerja e huas janë deklaruar rregullisht në DPV-të e viteve 2004 dhe 2005, ndërsa provat përkatëse janë dorëzuar së bashku me deklaratën Vetting. Në lidhje me datën e saktë të pagesës së shumave të borxhit ndaj vëllait e kam të pamundur ta kujtoj, pasi marrëdhënia ka qenë vëllazërore dhe nuk janë mbajtur shënime apo dokumente. Pagesat janë kryer pjesë-pjesë gjatë periudhave që vëllai vinte në shtëpi, kryesisht për pushimet verore dhe të fundvitit, në vitet 2004 dhe 2005. Ka pasur*

¹¹ Analiza financiare e shtetasit E.M.

¹² <https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

raste që ndonjë shumë t'i jetë dorëzuar edhe babait tim F.M, pasi vëllai jetonte në të njëjtën banesë me prindërit dhe me ekonomi të përbashkët. Përlllogaritja përfundimtare dhe mbyllja e detyrimit është bërë në fund të vitit 2005, kur vëllai im ka ardhur për festat e fundvitit”.

28.6. Analiza financiare për mundësinë e shlyerjes së huas ndaj shtetasit E.M

Analiza financiare për mundësinë e shlyerjes pjesore të huas në vlerën 4,000 euro gjatë vitit 2004

Tabela nr. 2.¹³

	6.4.2004 – 1.8.2004	1.9.2004 – 31.12.2004
Pasuria	0	101,138
<i>Ndryshim likuiditeti (shitesa/pakësime)</i>	-	101,138.00
Detyrime	-416,771.82	-457,594.77
Shlyerje të kredisë bankare	-163,291.82	-204,114.77
Pagesë e huas ndaj z. E. M	-253,480.00	-253,480.00
Pasuria neto	-416,771.82	-356,456.77
Të ardhura	599,874.34	749,842.91
Të ardhurat e subjektit	254,023.67	317,529.58
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit	345,850.67	432,313.33
Shpenzime	155,964.00	167,455.00
Shpenzime jetike 3 persona	93,964.00	117,455.00
Shpenzime qiraje për banim	12,000.00	-
Shpenzime mobilimi	50,000.00	50,000.00
Mundësia për kursime	860,682.16	938,844.68

Nga analiza e mësipërme duket se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi financiare për shlyerjen pjesore të huas në shumën 4,000 euro gjatë vitit 2004.

- *Analiza financiare për mundësinë e shlyerjes pjesore të huas në vlerën 6,000 euro gjatë vitit 2005*

Tabela nr. 3.¹⁴

	1.1.2005 – 1.8.2005	1.9.2005 – 31.12.2005
Pasuria	-714,031.26	-539,261.73
<i>Ndryshim likuiditeti (shitesa/pakësime)</i>	-714,031.26	-539,261.73
Detyrime	-681,000.93	-524,310.47
Kredia bankare BIA	-	-
Shlyerje e kredisë bankare	-313,380.93	-156,690.47
Huaja nga z. E.M	-	-
Pagesë e huas ndaj z. E. M	-367,620.00	-367,620.00
Pasuria neto	-33,030.33	-14,951.26
Të ardhura	1,473,786.67	736,893.33
Të ardhurat e subjektit	515,734.67	257,867.33
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit	696,633.33	348,316.67
Të ardhurat nga honoraret	261,418.67	130,709.33

¹³ Analiza financiare për mundësinë e shlyerjes së huas ndaj shtetasit E.M për shumën 4,000 euro.

¹⁴ Analiza financiare për mundësinë e shlyerjes së huas ndaj shtetasit E. M për shumën 6,000 euro.

Shpenzime	346,555.60	173,277.80
Shpenzime jetike 3 persona	219,114.00	109,557.00
TIMS	127,441.60	63,720.80
Mundësia për kursime	1,160,261.39	578,566.80

Nga analiza financiare duket se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi financiare për shlyerjen pjesore të huas në shumën 6,000 euro gjatë vitit 2005.

29. Hua e marrë në vlerën 20,000 euro në mars të vitit 2004 nga shtetasi Z. Ç

29.1. Për të vërtetuar huamarrjen nga shtetasi Z. Ç dhe të ardhurat e ligjshme të tij, të cilat kanë shërbyer si burim për dhënien e huas, subjekti i ka bashkëlidhur pyetësorit standard dhe pyetësorit të datës 4.3.2022 dokumentacionin e mëposhtëm:

- deklaratë noteriale nr. ***, datë 6.6.2019, të bashkëshortes së huadhënësit Xh.Ç, përmes së cilës deklaroi se në vitin 2004, së bashku me bashkëshortin e saj, i kanë dhënë hua z. Albert Meça shumën 20,000 euro të siguruar nga të ardhurat nga biznesi dhe kursimet familjare. Sipas deklaruësës, kjo shumë është likuiduar totalisht nga huamarrësi brenda afatit 2-mujor;
- ekstrakt historik i shoqërisë “E” sh.p.k. me NIPT J***D, me ortak dhe administrator shtetasen Xh.Ç, regjistruar në datën 1.7.1996;
- shkresë nr. ***prot., datë 4.11.2020, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, e cila konfirmon veprimtarinë e shoqërisë “E” sh.p.k., me NIPT J***D.
- shkresë nr. ***, datë 10.2.2020, e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (D.A dhe A), ku citohet se kompania “E” sh.p.k. ka zhvilluar aktivitet import-eksport nga viti 1997 e në vijim.

29.2. Komisioni ka kryer një hetim¹⁵ të plotë në lidhje me aftësinë financiare të shtetasve Z dhe Xh.Ç për dhënien e huas. Nga hetimi i kryer ka rezultuar:

- i) Bankat e nivelit të dytë nuk kanë vënë në dispozicion të Komisionit informacion në lidhje me llogaritë bankare të shtetasve Z dhe Xh.Ç, si dhe të shoqërisë “E” sh.p.k. për periudhën përpara vitit 2004.
- ii) “Raiffeisen Bank” informon se pas vitit 2005 shoqëria “E” sh.p.k. ka llogari nr. ***, me gjendje 745.40 lekë dhe llogari nr. *** me gjendje 32.84 euro, si dhe dy numra personalë *** dhe ***, të cilët janë aktualisht të mbyllur.
- iii) Qendra Kombëtare e Biznesit informon se shtetasja Xh.Ç figuron administratore dhe ortakë, zotëruese e 100% të kuotave në shoqërinë “E” sh.p.k., me NIPT J***D, regjistruar me vendimin nr. ***, datë 24.11.1994, me objekt aktiviteti “ Import eksport dhe tregtimi me shumicë e pakicë i të gjitha llojeve të mallrave, duke përfshirë ato ushqimore, industriale, karburanteve”.
- iv) DPSHTRR-ja informon se nga verifikimet e kryera në sistemin informatik të këtij institucioni nuk rezultojnë mjete të regjistruara në pronësi të shtetasve Z dhe Xh.Ç.
- v) ISSH-ja informon se në bazë të dokumenteve që disponon arkivi i këtij institucioni rezulton se:
 - a. shtetasja Xh.Ç figuron e punësuar pranë subjektit “Nd. e prodhimeve artistike Krujë” për periudhën 5.9.1966 – 10.3.1993;
 - b. shtetasi Z.Ç figuron i punësuar pranë subjektit “Komiteti ekzekutiv Krujë” për periudhën 1.9.1959 – 31.5.1994.

¹⁵ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.11.2021, e QKB-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.11.2021, e DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 19.11.2021, e ISSH-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 22.11.2021, e DPT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.4.2022, e DRT-së Durrës.

Në vërtetimet për vjetërsinë në punë për efekt pensioni, të vënë në dispozicion nga ISSH-ja, nuk evidentohet masa e pagës së përfituar nga këta shtetas.

- vi) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informon se shtetasja Xh.Ç rezulton administratore dhe ortakë me 100% të kuotave, në subjektin “E” sh.p.k. me NIPT J***D.
- vii) Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 10.1.2022, informon se shtetasja Xh.Ç, me ID F***H, është administratore dhe aksionere e tatimpaguesit “E” sh.p.k. me NIPT J***D, në Agjencinë Krujë, tatimpagues i cili nga data 22.12.2021 është me statusin pasiv. Nga verifikimi i të dhënave për tatimpaguesin “E” sh.p.k., sipas pasqyrave financiare për periudhën nga krijimi deri në vitin 2005, të dhënat janë paraqitur si më poshtë vijon:

Tabela nr. 4.

Nr.	Viti	Të ardhurat vjetore	Fitimi para tatimit sipas deklaramit
1	1996	45,031,139	808,444
2	1997	29,316,099	958,066
3	1998	10,698,439	3,432,654
4	1999	6,312,726	728,149
5	2000	7,368,924	1,074,977
6	2001	5,981,030	763,185
7	2002	5,315,682	143,639
8	2003	6,352,037	500,595
9	2004	4,763,272	202,698
10	2005	4,512,984	691,950

- viii) Drejtoria Rajonale Durrës ka vënë në dispozicion pasqyrat financiare të shoqërisë “E” sh.p.k. për vitet 2001 - 2004.

Nga analizimi i pasqyrave financiare të shoqërisë “E” sh.p.k. për vitet 2001 - 2004 rezulton se ky tatimpagues e ka akumuluar fitimin ndër vite, duke e përdorur për të likuiduar furnitorët e shoqërisë.

29.3. Bazuar në të dhënat e mësipërme konstatohet se:

- Xhiroja vjetore e shoqërisë “E” sh.p.k. në vitin 2004 ka qenë në shumën 4,763,272 lekë.
- Gjendja e arkës së shoqërisë “E” sh.p.k., në datën 31.12.2003, bazuar në pasqyrat financiare, ka qenë në vlerën 426,320 lekë.
- Fitimi i pashpërndarë i shoqërisë në total ka qenë në vlerën 8,409,709 lekë.
- Bankat e nivelit të dytë nuk kanë vënë në dispozicion të Komisionit informacion në lidhje me llogaritë bankare të shoqërisë “E” sh.p.k. përpara vitit 2004.

Për sa më sipër, nga ana e Komisionit nuk mund të evidentohet saktësisht aftësia huadhënëse e familjes Ç dhe, për rrjedhojë, shuma 20,000 euro, dhënë hua subjektit për blerjen e apartamentit, nuk do të përfshihet në analizën financiare.

29.4. Referuar përgjigjeve të subjektit në pyetësin standard, huaja e marrë nga shtetasi Ç është shlyer me kredinë e marrë në Bankën Italo-Shqiptare (sot “Intesa Sanpaolo Bank”) në maj të vitit 2004. Nisur nga ky deklaram, Komisioni ka administruar dokumentacionin e kredisë nga “Intesa Sanpaolo Bank”¹⁶, nga i cili rezultoi se në datën 28.4.2004 subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë nënshkruar kontratën e kredisë bankare nr. *** për vlerën 20,000 euro, me qëllim financimi “blerje apartamenti”. Referuar akteve të dosjes së kredisë, ajo është

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 4.11.2021, drejtuar “Intesa Sanpaolo Bank”; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 18.11.2021, e “Intesa Sanpaolo Bank”.

disbursuar në llogarinë dyemërore të subjektit dhe bashkëshortes në datën 6.5.2004 dhe shuma e disbursuar është tërhequr *cash* nga subjekti.

Referuar nenit 1 të kësaj kontrate, kthimi i kredisë do të kryhej me 72 këste mujore. Kredia bankare rezulton e siguruar me garancinë hipotekore të vendosur mbi apartamentin me sip. 105 m² të ndodhur në rrugën “M.Gj”. Në datën 14.5.2010, banka kredidhënëse ka nënshkruar deklaratën noteriale nr. ***, përmes së cilës konfirmohet shlyerja totale e kredisë, si dhe fshirja e inskriptit të vendosur mbi pasurinë kolateral.

Si rrjedhojë e kredimarrjes rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi financiare për shlyerjen e huas ndaj shtetasit Z.Ç në vlerën 20,000 euro.

30. Analiza financiare për pasurinë apartament

30.1 Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie në vlerën 2,854,498.67 lekë. Në analizë financiare nuk është përfshirë shuma 300,000 lekë dhuruar nga nëna e bashkëshortes së subjektit, trajtuar në pikën 44 të këtij vendimi, si dhe huaja në vlerën 20,000 euro.

30.2. Komisioni konstaton se në DPV/2004 subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash*, ndërsa në pikën 9 të pyetësorit të datës 4.3.2022, ka deklaruar se: “*Shumat e deklaruara në DPV janë konsideruar si gjendje cash në fund të vitit respektiv të deklarimit. Këto shuma janë përdorur në vite për shpenzimet e ndryshme të familjes apo si burime të krijimit të pasurive*”. Subjekti ka sqaruar se shumata e deklaruara gjendje *cash* në DPV/2003 janë përdorur për blerjen e apartamentit në vitin 2004, ndërkohë që në vitin 2004 nuk ka pasur gjendje *cash* dhe për këtë shkak në këtë vit nuk deklarohet gjendje *cash*.

Nga analizimi i deklarimeve periodike të subjektit dhe bashkëshortes rezulton se ai deklaroi në deklaratën periodike vetëm gjendjen *cash* të vitit të deklarimit, për pasojë, Komisioni e ka konsideruar shumën 800,000 lekë, të deklaruar si kursim nga subjekti në DPV/2003, si pakësim në vitin 2004, për sa kohë nuk ka deklaruar gjendje *cash* për këtë vit.

30.3. Në përfshirjen e kësaj shume, Komisioni është mbështetur në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit¹⁷, si dhe në leximin dhe analizën logjike të deklarimeve të bëra prej subjektit, qoftë në deklaratat periodike, qoftë në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, ku në çdo rast subjekti justifikon me burime të ligjshme pasurinë e deklaruar prej tij. Në çdo deklaram periodik nga subjekti nuk janë deklaruar shtesa dhe pakësime, por vetëm gjendja *cash* dhe gjendja në llogaritë bankare. Duke u bazuar në logjikën e deklarimeve të subjektit, Komisioni ka konsideruar se në ato deklarata periodike ku subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*, ajo është zeruar duke pakësuar në këtë mënyrë gjendjen *cash* të deklaruar nga subjekti në vitin paraardhës. Në lidhje me këtë çështje, Kolegji ka një qëndrim të konsoliduar tashmë, se pasaktësitë në deklarime periodike të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

31. Në përfundim, në lidhje me pasurinë “apartament”, Komisioni ka konstatuar se: (i) ka mospërputhje në deklarimin e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, pasi në deklaratën *Vetting* subjekti deklaroi se si burim kanë shërbyer të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes, ndërsa në DPV/2004, në seksionin “detyrime financiare”, ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit kredinë e marrë në shumën 20,000 euro dhe huan e marrë në shumën 10,000 euro; (ii) nga analiza financiare rezultoi se subjekti nuk pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në vlerën 2,854,498.67 lekë; (iii) nga hetimi nuk mund të provohet plotësisht aftësia financiare e familjes Ç për dhënien e huas në shumën 20,000 euro subjektit të rivlerësimit.

¹⁷ Vendim nr. 37/2021.

32. Subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit. Pas kalimit të barrës së provës subjekti parashtroi¹⁸ si më poshtë vijon:

32.1. Në lidhje me mospërputhjen në deklarin e burimit të të ardhurave për blerjen e apartamentit, subjekti ka prapësuar se në të dy deklaratat e sipërpërmendura ka pasqyruar gjendjen faktike të kësaj pasurie në momentin e plotësimit të deklaratës në përputhje me parashikimet e formularit përkatës, dhe konkretisht: në DPV/2004, në seksionin “pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, është deklaruar apartamenti dhe në seksionin “detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” janë evidentuar detyrimet financiare. Detyrimet financiare që kishte në 31 dhjetor 2004 ishin kredia ndaj bankës BIA dhe huaja ndaj të vëllait dhe, si të tilla, janë përshkruar saktësisht në rubrikat përkatëse të kësaj deklarate. Huaja bankare (kredia) dhe huaja e vëllait, që u përdorën për blerjen e apartamentit, sikurse është përmendur qartë në momentin e deklarin të kësaj pasurie në DPV/2004, janë shuma në të holla, të kthyeshme, të cilat janë përmbushur/paguar ndër vite nga të ardhurat e vetë subjektit dhe të bashkëshortes, sikurse është deklaruar në DPV-në përkatëse. Ky fakt provohet qartë edhe nga kontrata e kredisë, në të cilën pasqyrohet se qëllimi është blerja e këtij apartamenti, ku të ardhurat nga pagat kërkohen si kusht thelbësor për përmbushjen e këtij detyrimi dhe dhënien e kredisë.

Subjekti ka pretenduar se në deklaratën *Vetting* është deklaruar pasuria, përshkruar saktësisht sipas parashikimeve të kësaj deklarate deri në momentin e dorëzimit të saj, pasi në atë moment nuk ka pasur asnjë detyrim, të cilët ishin shlyer me të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes. Sipas subjektit, në momentin e deklarin sipas deklaratës *Vetting*, si kredia e marrë në bankën BIA (“Intesa Sanpaolo Bank”), ashtu edhe huaja e marrë vëllait, ishin shlyer, nuk përbënin më detyrime dhe nuk janë pasqyruar në asnjë nga zërat apo rubrikat e deklaratës *Vetting*. Në burimin e krijimit të apartamentit është përshkruar: “... nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes...”.

32.2. Në lidhje me pamjaftueshmërinë e të ardhurave në shumën 2,854,498.67 lekë, subjekti ka prapësuar se:

(a) në analizë, zëri “ndryshim likuiditeti”, nuk duhet të jetë -800,000 lekë, por -1,600,000 lekë, pasi në këtë analizë nuk është përfshirë shuma 800,000 lekë e deklaruar si gjendje *cash* nga bashkëshortja M.M në DPV/2003 të saj. Në këtë deklaratë bashkëshortja ka deklaruar veçmas pasuritë e saj, përfshirë edhe shumën *cash* prej 800,000 lekësh, të cilat kanë si burim kursime të të ardhurave të saj dhe të subjektit. Deklarimi veçmas është bërë jo vetëm për shkak të mungesës së përvojës (viti i parë i zbatimit të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003), por edhe sepse kuadri ligjor në fuqi në këtë kohë parashikonte deklarin veçmas. Fakti se në DPV/2003 janë deklaruar veçmas pasuritë konstatohet lehtësisht, pasi pasuritë e vetë subjektit nuk figurojnë në DPV-në e bashkëshortes dhe pasuritë e saj nuk figurojnë në DPV-në e subjekti.

ILDKPKI, në aktin e kontrollit për deklaratën *Vetting*, e ka pranuar këtë deklarin të subjektit dhe bashkëshortes si deklarime të bëra veçmas. Konkretisht, në deklaratën "Para fillimit të detyrës 2003" bashkëshortja e subjektit ka deklaruar pasuri në vlerën 800.000 lekë dhe apartament në Elbasan i deklaruar me burim trashëgiminë; në deklaratën “Para fillimit të detyrës 2003” subjekti ka deklaruar pasuri në vlerën 1.050.000 lekë.

(b) të ardhurat e bashkëshortes të pasqyruara në tabelën e analizës financiare kanë një pasaktësi në shumë, për arsye se në vërtetimin e të ardhurave nga paga, nga puna si nëpunës civil në Kryeministri, të vënë në dispozicion nga subjekti, nuk ishte evidentuar saktë shuma e të ardhurave, për shkak të punës jashtë orarit dhe shpërblimet. Subjekti pretendon se shuma e të ardhurave të bashkëshortes duhet të jetë 440,196 (katërqind e dyzet mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë, në vend të 345,850 (treqind e dyzet e pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë.

¹⁸ Për më shumë shihni shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti në datën 7.7.2022.

Për të mbështetur këtë pretendim ai ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 28.3.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, për pagat e bashkëshortes për periudhën nëntor 2002 – 2016 dhe vërtetimin nr. *** prot., datë 6.4.2022, të Drejtorit të Departamentit të Miradministrimit në Kryeministri, për pagat e bashkëshortes për periudhën janar – dhjetor 2004.

32.3. Në lidhje me aftësinë financiare të familjes Ç për dhënien e huas në shumën 20,000 euro, subjekti ka prapësuar me dy argumente, si vijon:

i) Ai ka parashtruar se në mars të vitit 2004 ka rënë dakord parimisht që të blejë një apartament të ndodhur në rrugën “M. Gj” në Tiranë. Si burime për blerjen e këtij apartamenti kishte planifikuar përdorimin e kursimeve të tij dhe të bashkëshortes, marrjen e një shume kredi bankare dhe marrjen e një huaje nga vëllai i tij E.M. Pasi ka nisur procedurat për marrjen e një kredie bankare në Bankën Italo-Shqiptare Tiranë, kjo e fundit ka pranuar që t’ia japë kredinë, por i ka kërkuar që apartamenti (që do të blihej) ose një pasuri tjetër e paluajtshme të vendosej si kolateral/garanci për marrjen e kredisë. Gjatë kohës së negociatave dhe procedurave administrative për marrjen e kredisë shitësi i apartamentit O.B (B) dhe bashkëshortja e tij i kanë bërë me dije subjektit se duhet të largoheshin në Itali dhe se nuk kishin mundësi të prisnin lëvrimin e kredisë apo pagimin e shumës së parave në një moment të dytë (pas lëvritimit/disbursimit të kredisë bankare). Ata kërkonin pagimin e shumës *cash* ose në të kundërt apartamentin do t’ia shisnin një blerësi tjetër. Fakti se shitësit O dhe S.B janë larguar një ditë pas nënshkrimit të kontratës së shitjes së apartamentit provohet me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.7.2022, të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë dhe regjistri me prot. **, viti 2004 i “hyrje - daljeve për shtetas shqiptarë”.

Duke qenë në një situatë të tillë, subjekti pretendon se ka kërkuar ndihmën e familjarëve të tij për të siguruar shumën 20,000 euro. Konkretisht, një shumë e tillë i është dhënë nga daja dhe bashkëshortja e tij Z dhe Xh. Ç, me kushtin që t’i kthehej sapo të lëvrohej kredia, pasi nuk mund të bllokonin një shumë të tillë për një kohë të gjatë. Kjo shumë është marrë hua vetëm për disa ditë.

Subjekti ka pretenduar se bazuar në rrethanat e mësipërme shuma 20,000 euro e marrë nga familja Ç nuk duhet marrë në shqyrtim si marrëdhënie huaje, në kuptim të nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Faktikisht, si burim financiar për blerjen e pasurisë “apartament” ka shërbyer shuma 20,000 euro e marrë kredi nga banka, ndërsa shuma 20,000 euro, e marrë nga familja Ç, është përdorur vetëm disa ditë si mjet për realizimin e disbursimit/lëvritimit fizik të kredisë. Huaja e marrë nga familja Ç nuk është marrë me qëllim blerjen e apartamentit, por mundësimin e marrjes së kredisë bankare, pasi në planifikimin e mundësive për blerjen e apartamentit subjekti dhe bashkëshortja e tij pretendojnë se kanë llogaritur marrjen e kredisë bankare dhe shlyerjen e saj në vite.

Për të përforcuar parashtrimet e tij, subjekti i është referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit me qëndrimet e mbajtura në vendimet nr. 24/2021, nr. 1 datë 27.1.2022 dhe nr. 31/2020. Ai ka kërkuar që marrëdhënien e krijuar me familjen Ç të mos konsiderohet sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

ii) Për të provuar aftësinë financiare të familjes Ç për huadhënien në vlerën 20,000 euro, subjekti ka paraqitur në prapësimet e tij:

Mandate/urdhër tërheqjeje nga shtetasi Z. Ç për periudhat qershor – nëntor 2003 dhe janar – prill 2004, tërhequr *cash* nga llogaria bankare e shoqërisë “E” sh.p.k. në Bankën e Kursimeve shumën 29,040 euro:

- urdhër tërheqjeje AA***, datë 9.1.2004, shuma 4,750 euro;
- urdhër tërheqjeje ***, datë 25.2.2004, shuma 3,370 euro;
- urdhër tërheqjeje ***, datë 27.2.2004, shuma 4,100 euro;

- urdhër tërheqjeje ***, datë 11.3.2004, shuma 2,200 euro;
- urdhër tërheqjeje ***, datë 26.3.2004, shuma 4,000 euro;
- urdhër tërheqjeje ***, datë 29.4.2004, shuma 3,400 euro;
- urdhër tërheqjeje ***, datë 5.6.2003, shuma 4,000 euro;
- urdhër tërheqjeje ***, datë 4.11.2003, shuma 3,220 euro.

Shkresën nr. *** prot., datë 10.2.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (Departamenti i Analizave dhe Aposteriorit) me të cilën rezulton e provuar se kompania “E” sh.p.k. ka zhvilluar aktivitetet import-eksport për periudhën 1997 - 2020.

Deklaratat e eksportit me anë të së cilave rezulton e provuar se vetëm në periudhën janar – prill 2004 shoqëria “E” sh.p.k. ka pasur aktivitet eksporti me shuma të konsiderueshme, konkretisht:

- sipas deklaratës EXP *, datë 22.1.2004, shuma totale e faturuar është 22,582 euro;
- sipas deklaratës EXP *, datë 28.2.2004, shuma totale e faturuar është 24,315 euro;
- sipas deklaratës EXP *, datë 24.3.2004, shuma totale e faturuar është 16,432 euro;
- sipas deklaratës EXP *, datë 24.4.2004, shuma totale e faturuar është 23,367 euro;

Subjekti evidenton se në periudhën e ushtrimit të aktivitetit të saj deri në momentin e dhënies së huas, shoqëria “E” sh.p.k. ka realizuar nga xhiro prej më shumë se 121,000,000 lekësh (rreth 1.000.000 euro) dhe ka paguar tatimet përkatëse për një fitim prej më shumë se 8,600,000 lekësh. Shuma 20,000 euro (e konvertuar në lekë rreth 2,500,000 lekë), që i është dhënë subjektit, përbën rreth 2% të xhiros së shoqërisë ose 33 % të fitimit të saj. Duke qenë se shtetasja Xh.Ç është ortake e vetme e shoqërisë dhe administratore e saj, është krejtësisht e mundshme që në një moment të caktuar të kishte mundësinë e përdorimit për një afat 35 ditë të një shume sa 2% të xhiros së shoqërisë në vite.

Subjekti ka pretenduar se edhe në qoftë se do të pranohet se fitimi i shoqërisë “E” sh.p.k. në vitet 2001 - 2004 është riinvestuar apo përdorur nga shoqëria, përsëri rezulton se fitimi i shoqërisë për vitet 1996 - 2000 është rreth 7,000,000 lekë. Pra, kjo shumë ka qenë në dispozicion të administtores dhe pronares së vetme të shoqërisë dhe mund të përdorej për çdo qëllim. Subjekti vë në dukje se në atë kohë operohej me *cash* dhe subjektet tregtare mbanin gjendje arke shuma të konsiderueshme që i vinin në përdorim për periudha të shkurtra kohore dhe më pas i rikthenin në arkë apo kryenin pagesat ose likuidonin detyrimet.

Nisur nga fakti i mungesës së informacionit të plotë financiar dhe kontabël të aktivitetit të kësaj shoqërie, përfshirë dokumentacionin që përshkruan organizmin dhe procedurat kontabël të saj, për periudhën deri në vitin 2004, por duke iu referuar dokumentacionit të administruar nga Komisioni nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 10.1.2022, të DRT-së Durrës, rezulton se në bilancin kontabël të vitit 2001, në postin e kapitaleve të veta “kapitali i nënshkruar” (rr. **); “rezerva statutore” (rr. **); “rezerva të tjera” (rr.**); dhe “fitim ose humbje të ushtrimit” (rr. **), janë pasqyruar përkatësisht vlerat 1,112,503 lekë; 4,131,101 lekë; 910,885 lekë dhe 572,389 lekë, ndërsa në bilancin kontabël të vitit pasardhës (2002), zëri “kapitali i nënshkruar”, është paraqitur në shumën 100,000 lekë, ndërsa zëri “rezervat statutore”, “rezervat e tjera” dhe “fitim ose humbje të mbartura”¹⁹ nuk kanë vlerë të pasqyruar. Nga ana e drejtueses dhe ortakes së shoqërisë në vitin 2002, mbështetur në dispozitat ligjore dhe statutore përkatëse²⁰, është kryer zvogëlim i kapitalit të nënshkruar (në vlerën 1,012,503 lekë), tërheqje/për përdorim të rezervave (në vlerën 5,031,986 lekë), si dhe tërheqje/shpërndarje e fitimit të ushtrimit/dividend për vitin 2001 (në vlerën 572,389 lekë). Pra, vlera prej 6,616,878 lekësh ka qenë në përdorim të administratorit/ortakut të vetëm të shoqërisë nga viti 2002. Subjekti ka pretenduar se e ka të pamundur të saktësojë nëse shuma që i është dhënë hua ishte (plotësisht apo pjesërisht) pjesë e fitimit të shoqërisë, e xhiros së shoqërisë, gjendjes së arkës apo kursimeve të familjes Ç në vite.

¹⁹ Pjesa prej 10,000 lekësh transferuar në rezerva ligjore.

²⁰ Ligji nr. 7661/1993, “Për kontabilitetin”.

Ajo që ka rëndësi në këtë proces, ka theksuar subjekti, është fakti se cilido të jetë burimi i shumës që i është dhënë hua, burimi është i ligjshëm në kuptim të nenit 32, pg. 4 i ligjit nr. 84/2016 dhe i provuar me provat e paraqitura.

33. Pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, Komisioni çmon se:

i) Në lidhje me mospërputhjen në deklarin e burimit të të ardhurave për pasurinë apartament, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë të burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen këtij apartamenti në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, sipas percaktimeve të germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, por fakti se procedurat për marrjen e kredisë kishin filluar para blerjes së pasurisë/kryerjes së pagesave, marrja e huasë ka qenë për një kohë të shkurtër, pasuria e krijuar është vendosur kolateral menjëherë dhe marrëdhënia e kredisë është deklaruar dhe shlyer rregullisht ndër vite, Komisioni krijon bindjen se kjo pasaktësi në deklarin nuk ka qenë e qëllimshme, për më tepër që kjo pasaktësi nuk shoqërohet me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për shumën e marrë hua, prandaj nuk mund të kualifikohet si një shkak penalizues për aplikimin e nenit 61 pika 3, të ligjit nr. 84/2016. Ky arsyetim vjen në harmoni edhe me praktikën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në vendimin nr. 31/2020 (JR), datë 18.11.2020.

ii) Në lidhje me pretendimin e subjektit për përlllogaritjen e zërit “ndryshim likuiditeti” në vlerën 1,600,000 lekë, ai nuk gjen mbështetje në përmbajtjen e deklaratave periodike të vitit 2003 të subjektit dhe bashkëshortes së tij, në të cilat deklarojnë respektivisht:

- subjekti në DPV/2003 deklaroi *gjendje cash në vlerën 800,000 lekë me burim “kursime”, pa deklaruar pjesën e tij takuese;*
- bashkëshortja e subjektit në DPV/2003 deklaroi *vlerë monetare në bashkëpronësi 800,000 lekë në cash me burim “kursime, paga vetjake dhe paga e bashkëshortit”.*

Nga përmbajtja e këtyre deklarimeve evidentohet se gjendja *cash* e deklaruar nga bashkëshortët Meça është në total 800,000 lekë. Për pasojë, pretendimi i subjektit për përlllogaritjen e zërit “ndryshim likuiditeti” në vlerën 1,600,000 lekë nuk do të konsiderohet në analizën financiare të Komisionit, duke u llogaritur si kursim vetëm shuma 800,000 lekë.

iii) Në lidhje me pagat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit, Komisioni ka kryer rilllogaritjen sipas vërtetimeve të saktësuar, të paraqitura së bashku me prapësimet nga subjekti. Për vitet 1992 - 2007 Komisioni ka përfshirë në analizë financiare të ardhurat nga paga, bazuar në vërtetimet e paraqitura në prapësime nga subjekti i rivlerësimit, pasi pagat e këtyre viteve nuk reflektohen të plota në sistemin bankar. Në vijim, nga viti 2007 deri në deklaratën *Vetting* Komisioni nisur nga kërkesa e subjektit, dhe nga mospërputhja e të dhënave të vërtetimeve me ato të pasqyruara në veprimet bankare, ka përfshirë në analizë financiare të ardhurat nga paga të evidentuara nga nxjerrjet e llogarive bankare të subjektit dhe bashkëshortes së tij.

iv) Lidhur me pretendimin e subjektit për të mos e konsideruar marrëdhënien me familjen Ç si marrëdhënie huamarrjeje, vlerësohet se nuk qëndron, pasi kjo është një marrëdhënie e mirëfilltë huaje, sipas parashikimeve të nenit 1050 të Kodit Civil, ku përcaktohet se: *“Me kontratën e huas njëra palë (huadhënësi) i jep në pronësi palës tjetër (huamarrësit) një shumë të hollash [...] dhe huamarrësi detyrohet t’i kthejë huadhënësit atë të holla [...] brenda afatit të caktuar në kontratë ose, kur nuk është caktuar afat, me kërkesën e huadhënësit...”*. Në rastin konkret, subjekti, në cilësinë e huamarrësit, ka zotëruar dhe përdorur të hollat, duke ushtruar të gjitha tagrat e pronësisë dhe më pas është detyruar t’i kthejë sipas dakordësisë me palën huadhënëse. Për pasojë, vlerësohet se përcaktimet e pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 gjejnë aplikim në rastin e marrëdhënies së krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe familjes Ç në cilësinë e “personit tjetër të lidhur”, pasi mes tyre ekziston një marrëdhënie huadhënie-huamarrjeje, e cila e detyron subjektin e rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë në transaksion.

v) Në lidhje me jurisprudencën e Kolegjit dhe vendimet e cituara nga subjekti, nga analizimi i këtyre vendimeve rezulton se rrethanat e marrëdhënies së huadhënies së trajtuara në përmbajtje të tyre janë të ndryshme nga ato të subjektit të rivlerësimit ndaj qëndrimet e mbajtura nga Kolegji nuk mund të përdoren si referencë për vlerësimin e situatës së huamarrjes së subjektit.

vi) Komisioni, duke marrë në konsideratë provat e reja të depozituar nga subjekti dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ, konstaton se:

- Shtetasi Z.Ç ka tërhequr gjatë vitit 2003 - 2004 nga llogaria e shoqërisë “E” sh.p.k. shumën 29,040 euro.
- Shoqëria “E” sh.p.k. për periudhën janar - mars 2004 ka pasur të ardhura nga eksportet në shumën 63,239 euro.
- Fitimi i pashpërndarë i shoqërisë “E” sh.p.k. është në total në shumën 8,409,709 lekë.
- Veprimet financiare të huamarrjes janë kryer midis personave që gjendeshin në një marrëdhënie të veçantë (dajë-nip) dhe kjo konsiderohet si një rrethanë mirëbesimi, bindëse, lidhur me mungesën e nënshkrimit të një deklarate noteriale në momentin e dhënies dhe kthimit të huas në fjalë.
- Pala shitëse e apartamentit është larguar nga territori shqiptar vetëm një ditë pasi kanë nënshkruar kontratën e shitjes dhe kanë përfituar/arkëtuar çmimin përkatës, duke jutfikuar kështu urgjencën në kryerjen e veprimeve.
- Subjekti kishte nisur bisedimet me bankën dhe kishte paraqitur kërkesën për kredi, me herët se të merrte huanë nga daja i tij, ndërthurur me urgjencën e paraqitur nga shitësit për të marrë shumën përkatëse, i bën të besueshme shpjegimet e subjektit, se ai si burim të parashikuar kishte kredinë bankare, dhe huaja ka qënë një mjet financiar i përkohshëm, deri në momentin e disbursimit të kredisë.

Nga të dhënat e mësipërme financiare provohet se familja Ç ka pasur likuiditete në qarkullim në shuma të konsiderueshme, të cilat tejkalojnë vlerën e dhënies së huas në shumën 20,000 euro. Referuar vendimeve nr. 20/2019 (JR)²¹ dhe nr. 15/2019 (JR)²² të Kolegjit, duke marrë në konsideratë që: (i) huaja në shumën 20,000 euro është dhënë për një afat 35-ditor dhe menjëherë pas marrjes së kredisë është shlyer; (ii) subjekti nuk ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2004 marrjen dhe kthimin e kësaj huaje, për sa kohë është kthyer brenda vitit kalendarik; (iii) deklaramit nga ana e subjektit të kësaj huaje në pyetësin standard duke korrigjuar deklaramin e tij në deklaratën *Vetting*, trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave, kushteve, fakteve, shpjegimeve dhe provave subjekti arriti të provojë ekzistencën formale të marrëdhënies 35-ditore të huas me shtetasin Z.Ç, si dhe aftësinë financiare të familjes Ç për dhënien e kësaj huaje.

²¹ Sipas së cilit: “... për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar rasteve konkrete e rrethanave specifike të tyre, përveç rasteve të ekzistencës së dyshimeve për pasuri të fshehura në emër të personave të tjerë të lidhur...”.

²² Sipas së cilit: “... në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur. Pavarësisht, ky arsyetim në asnjë rast nuk duhet të pengojë organet e rivlerësimit që të hetojnë çdo situatë të dyshuar se personat e tjerë të lidhur mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo se janë përdorur për të fshehur ekzistencën e një marrëdhënieje që të çon në një situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me një person tjetër, dyshim i cili duhet të ngrihet mbi rrethana objektive”.

Komisioni, në vlerësim të përgjithshëm të sa më sipër, për sa kohë nuk mund të përjashtohet përdorimi i përkohshëm nga subjekti i vlerës 20.000 euro, i mjeteve monetare të provuara si të mjaftueshme, të disponuara nga daja dhe aktiviteti i tij në mars 2004, çmon se kjo rrethanë në vetvete nuk mund të mjaftojë për të pasqyruar penalizimin e subjektit të rivlerësimit.

Në kushtet kur Komisioni pranoi disa nga pretendimet e subjektit, u krye një analizë e re financiare për blerjen e këtij apartamenti, duke përfshirë dhe pagat e marra nga bashkëshortja e subjektit, sipas vërtetimeve të paraqitura në prapësime. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë “apartament” në shumën 225, 353.33 lekë.

Komisioni, duke marrë në konsideratë vlerën e ulët të mungesës së burimeve të ligjshme për këtë pasuri, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, vlerëson se nuk klasifikohet si deklaram i pamjaftueshëm për të shërbyer si shkak autonom për shkarkimin e subjektit nga detyra.

34. Automjet²³ tip “Mercedes-Benz E*CDI”, me targa TR ***S, vit prodhimi 1999, regjistruar me certifikatën nr. ***, blerë më 9.3.2009, me çmim blerjeje 800,000 lekë**

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhura nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes M.M.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- Rezulton se në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë 2009 dhe në deklaratën e pasurisë *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar pagesë doganore në shumën 279,931 lekë.

Hetimi²⁴ dhe arsyetimi juridiko-financiar i kryer nga Komisioni

34.1. Subjekti, me kontratën e shitjes së automjetit nr. ***, datë 9.3.2009, ka blerë automjetin tip “D.C E***CDI” (vit prodhimi 1999) në shumën 800,000 lekë. Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, pagesa e çmimit të shitjes në favor të shitësit A.R është kryer jashtë zyrës noteriale.

34.2. Referuar deklaratës doganore *Import **, rezulton se shitësi A.R e ka blerë këtë automjet në datën 26.1.2009 në Gjermani në vlerën 346,640 lekë²⁵ dhe ka paguar detyrimet tatimore në vlerën 279,373 lekë. Pagesa e detyrimit tatimor nga shtetasi A.R provohet edhe nga urdhërçlirimi, datë 29.1.2009, i Doganës Durrës. Pra, në total shitësi ka paguar shumën 626,013 për blerjen e këtij automjeti.

34.3. Subjekti e ka deklaruar këtë automjet në DPV/2009, me përshkrimin “blerje automjeti tip Benz, në vlerën 800,000 lekë”, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie. Gjithashtu, në DPV/2009 subjekti ka deklaruar pakësimin e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank” në emër të bashkëshortes M.M, në vlerën 216,000 lekë, si dhe pakësimin e llogarisë bankare të kësaj të fundit në “Intesa Sanpaolo Bank” në vlerën 168,000 lekë.

34.4. Referuar burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të blerjes së këtij automjeti të ardhurat e përfituara nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij.

34.5. Analiza financiare

Tabela nr. 5.²⁶

²³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës (i) certifikatë pronësie automjeti me targa TR *** S; (ii) leje qarkullimi; (iii) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 9.3.2009; (iv) deklaratë doganore + mandat BKT, datë 29.1.2009, pagesë dogane në vlerën 279,931 lekë + praktika.

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 22.1.2020, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.1.2020, e DPSHTRR-së.

²⁵ Vlera e blerjes 2,800 euro, konvertuar në lekë sipas kursit të këmbimit të përcaktuar në deklaratën doganore *Import **.

²⁶ Analiza financiare për blerjen e pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz” në vitin 2009.

	Datë 9.3.2009
Pasuria	-210,476.18
Automjet tip “Mercedes-Benz”	800,000.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>-1,010,476.18</i>
Detyrime	-137,170.00
Shlyerje të kredisë bankare	-137,170.00
Pasuria neto	-73,306.18
Të ardhura	648,100.02
Të ardhurat e subjektit	283,939.69
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit	283,760.33
Të ardhura nga interesa bankare nga bono thesari	80,400.00
Shpenzime	91,080.00
Shpenzime jetike	91,080.00
Mundësia për kursime	630,326.20

Nga analiza financiare duket se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit.

34.6. Në përfundim konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri. Subjekti ka pasur burime financiare të mjaftueshme dhe të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

35. Vendparkim²⁷ për automjet, porositur (parapaguar) në një pallat në ndërtim në rrugën “M.Gj”, me kontratën e datës 15.5.2014, në vlerën 500,000 lekë

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhurat nga paga e subjektit dhe bashkëshortes M.M.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- Rezulton se në deklaratën e interesave private periodike/vjetore 2014 dhe në deklaratën e pasurisë *Vetting* nuk është deklaruar sipërfaqja e përfituar nga kontrata e sipërmarrjes për vendparkimet, por vetëm vlera 500,000 lekë.

Hetimi²⁸ dhe arsyetimi juridiko-financiar i kryer nga Komisioni

35.1. Subjekti, me kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 15.5.2014, ka porositur nga shoqëria “A” sh.p.k., dy vendparkime sipas projektit për ndërtimin e godinës së banimit në pronën e pronarëve K. Në nenin 2 të kontratës së sipërmarrjes citohet se vlera e dy vendparkimeve do të jetë 500,000 lekë, e cila është likuiduar nga blerësi në prezencë të noterës.

Subjekti pagesën e dy vendparkimeve e ka provuar me mandatarkëtimin nr. **, datë 15.5.2014, që i është bashkëlidhur kontratës së sipërmarrjes. Në këtë mandatarkëtim, ndryshe nga sa është përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes, konstatohet se pagesa është bërë për blerje parkimi, garazh.

35.2. Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në DPV/2014, me përshkrimin “porositur (parapaguar) vendparkim për automjet në një pallat në ndërtim në rr. ‘M.Gj’, me kontratën e datës 15.5.2014, në vlerën 500,000 lekë” dhe burim krijimi të kësaj pasurie të ardhurat personale dhe të bashkëshortes. Bazuar në përgjigjen e ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Jug rezulton se në

²⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 15.5.2014; (ii) mandat nr. **, datë 15.5.2014.

²⁸ Aplikim në portalin elektronik të ASHK-së me nr. ***, datë 25.2.2022; shkresë kthim përgjigjeje elektronike datë 5.3.2022, e ASHK-së; shkresë nr. *** prot., datë 4.11.2021, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 17.11.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

emër të subjektit është regjistruar pasuria e llojit “garazh” me sip. 31.8 m², me nr. ***, z. k. ***, ndodhur në Tiranë.

35.3. Në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit, Komisioni ka mbajtur korrespondencë me institucionin punëdhënës të subjektit të rivlerësimit, i cili, në përgjigjen e tij, konfirmon se shitësi i kësaj pasurie, shoqëria “A” sh.p.k., dhe ortakët e saj nuk kanë pasur çështje gjyqësore të gjykuara nga subjekti.

35.4. Në përgjigje të pyetësorit të datës 4.3.2022 në lidhje me vendparkimet, subjekti ka deklaruar: *“Pasuria vendparkim/garazh është porositur me kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 15.5.2014, lidhur me shoqërinë ‘A’ sh.p.k. para noteres M.Sh. Në këtë moment është kryer edhe pagesa sipas mandatit të arkëtimit. Kontrata e sipërmarrjes është lidhur bazuar në dokumentacionin (planimetrinë) e lejes së ndërtimit të dhënë me vendimin nr. ***, datë 12.10.2008, të KRT-së, Bashkia Tiranë. Në vitin 2020 kanë nisur procedurat e legalizimit dhe regjistrimit të të gjithë pallatit nga vetë banorët, përfshirë edhe legalizimi dhe regjistrimi i vendparkimit/garazhit. Procedurat e legalizimit dhe regjistrimit për këtë vendparkim/garazh janë kryer nga ana ime dhe kanë përfunduar në vitin 2021. Pas përfundimit të këtyre procedurave, prona është e regjistruar në emrin tim me nr. prone: ***, zona kadastrale ***, volumi **, faqe ***, Zyra e Regjistrimit ZVRPP DR Tirana Jug. Ky fakt është i pasqyruar në certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, lëshuar në datën 25.1.2021”.*

35.5. Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes së tij dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. kopje të certifikatës së pronësisë për pasurinë “garazh” me nr. pasurie ***, lëshuar nga ZVRPP/ASHK në datën 25.1.2021;
- ii. kopje të kartelës dhe hartës treguese të pasurisë “garazh” me nr. pasurie ***, lëshuar nga ZVRPP/ASHK në datën 1.2.2021;
- iii. kopje të lejes së legalizimit nr. ***, datë 28.9.2020, miratuar në favor të subjektit të rivlerësimit, shoqëruar me fragmentin e hartës kadastrale, planimetrinë dhe genplanin përkatës.

35.6. Në përgjigje të pyetësorit të datës 4.3.2022, në lidhje me çmimin e porositjes së vendparkimeve, subjekti ka deklaruar: *“Çmimi është dakordësuar midis palëve referuar rregullave dhe parimeve të tregtisë së lirë dhe është pasqyruar edhe në kontratën përkatëse. Në këtë çmim kanë ndikuar edhe faktet e mëposhtme:*

i. Sipas planimetrisë së lejes së ndërtimit figurojnë 2 vendparkime, por në fakt hapësira lejon parkimin e vetëm 1 (një) automjeti. Ky fakt është lehtësisht i konstatueshëm nga gjendja aktuale (de facto) e vendparkimit, si dhe nga dokumentacioni (de jure) i certifikatës së pronësisë lëshuar nga ZVRPP DR Tirana Jug. Në planimetrinë e pronës dhe katit në tërësi pasqyrohet qartë se është vetëm një vendparkim. Sipas planimetrisë së lejes së ndërtimit duhet të ndërtohen të paktën 48 vendparkime, por faktikisht janë vetëm 15 të tilla, fakt që rezulton edhe nga planimetria e regjistrimit të pronës ZVRPP DR Tirana Jug, bashkëlidhur certifikatës së pronësisë.

ii. Fakti se në kontratën e sipërmarrjes investitori sipërmarrës nuk pranoi të përcaktonte shprehimisht sipërfaqen për shkak të ndryshimeve që ai po bënte në projekt. Verbalisht është dakordësuar që investitori do të më dorëzonte vendparkimin/garazhin, pasi të përmbushte detyrimet e porositësve të tjerë në lidhje me vendparkimet/garazhet. Mungesa e sipërfaqes konstatohet edhe nga kontrata e sipërmarrjes dhe rriste dukshëm rrezikun e mospërmbushjes së saj.

iii. Fakti se ndërtuesi mund të kishte shkelje të lejes së ndërtimit për shkak të kohës së gjatë të punimeve dhe mosrealizimit të tyre në mënyrën e duhur, që shpjegohet edhe me ndjekjen e procedurave të regjistrimit të pronës nga porositësit. Kjo situatë krijonte edhe pasiguri në lidhje me cilësinë e punimeve, përfundimin e tyre dhe përmbushjen e kontratës.

iv. Fakti se një pjesë e madhe e sipërfaqes është jofunksionale (ndodhet pas kolonave të betonit).

v. Fakti se pozicionimi i vendparkimit në -2 kate nën tokë nuk është praktik për shkak të pjerrësisë dhe ngushtësisë së korridoreve të përbashkët. Gjithashtu, në rastet kur sasia e reshjeve (shiu) është e madhe, sistemi i kanalizimeve nuk i përballon prurjet dhe uji futen në katet e poshtme të pallatit, ku ndodhet vendparkimi.

vi. Fakti se shitësi e kërkonte të gjithë pagesën menjëherë dhe cash (me lekë në dorë).

vii. Fakti se të gjithë porositësit e vendparkimeve/garazheve janë banorë të pallatit, pasi kanë apartamentet e tyre në këtë pallat. Unë jam i vetmi që nuk jam banor i pallatit, pasi banesa/apartamenti im ndodhet në një pallat 15-20 metra larg hyrjes së vendparkimit/garazhit”.

35.7. Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes së tij kontratat si më poshtë:

- a. kontratë shitjeje nr. *** rep., *** kol., datë 1.3.2019, sipas së cilës një garazh me sip. 31.8 m², me vendndodhje në rrugën “B.C”, është shitur 2,000 euro;
- b. kontratë shitjeje nr. *** rep., *** kol., datë 10.4.2018, sipas së cilës një garazh me sip. 42.5 m², me vendndodhje në rrugën “T.D”, është shitur 5,000 euro;
- c. kontratë shitjeje nr. *** rep., *** kol., datë 1.3.2019, sipas së cilës një garazh me sip. 16.6 m², me vendndodhje në rrugën “B.C”, është shitur 1000 euro;
- d. kontratë shitjeje nr. *** rep., *** kol., datë 21.9.2016, sipas së cilës janë shitur 11 poste parkimi me sipërfaqe rreth 20 m², me vendndodhje në rrugën “Komuna e Parisit” për çmimin 2,000 euro secili;
- e. kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., ***kol., datë 13.8.2012, sipas së cilës shoqëria “A” sh.p.k., në të njëjtin pallat ku ndodhet vendparkimi i subjektit, ka porositur njësi zyrë me sip. 35 m², me çmim 22,000 euro.

35.8. Nga analizimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer procedurat e pajisjes me leje legalizimi nr. ***, datë 28.9.2020, në përputhje me parashikimet e VKM-së nr. 19, datë 11.1.2017, “Për përcaktimin e rregullave të legalizimit të objekteve me leje ndërtimi, në të cilat janë kryer shtesa anësore dhe/ose në lartësi ose ndryshime të funksionit të hapësirave dhe të objekteve shumëkatëshe pa leje, të destinuara për kalimin e së drejtës së pronësisë apo qiradhënien”, ndryshuar me tej me VKM-në nr. 1180, datë 24.12.2020.

Bazuar në përcaktimet e kësaj VKM-je, poseduesit e njërive individuale dorëzojnë në ASHK dokumentacionin që provon marrëdhënien juridiko-civile me subjektin ndërtues/investitor e më tej drejtoria vendore e ASHK-së miraton aktet e legalizimit për njësitë individuale në favor të poseduesve, sipas kontratave ose aktmarrëveshjeve përkatëse.

Në përputhje me këtë VKM, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë pajisur me leje legalizimi për garazhin me sip. 31.8 m². Nga përmbajtja e lejes së legalizimit rezulton se titulli i pronësisë mbi objektin e legalizuar është vërtetuar me kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 15.5.2014. Në vijim, në datën 25.1.2021, subjekti është pajisur me certifikatë pronësie për garazhin me nr. pasurie ***.

35.9. Analiza financiare për pasurinë “vendparkim/garazh”

Në deklaratën *Vetting* subjekti deklaroi se burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

Tabela nr. 6.²⁹

	Datë 15.5.2014
Pasuria	154,192.73

²⁹ Analiza financiare për pasurinë vendparkim/garazh.

Vendparkim, datë 15.5.2014	500,000.00
<i>Ndryshim likuiditeti (shtesa/pakësime)</i>	-345,807.27
Detyrime	0.00
Pasuria neto	154,192.73
Të ardhura	1,168,175.71
Të ardhurat e subjektit	466,025.83
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit	519,761.67
Të ardhura nga interesa bankare nga depozita	29,262.08
Të ardhura nga interesa bankare nga bono thesari	107,181.73
Të ardhura nga honoraret	45,944.40
Shpenzime	551,496.10
Shpenzime jetike	366,663.33
TIMS	184,832.76
Mundësia për kursime	462,486.89

Nga analiza financiare duket se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie.

35.10. Nga hetimi i kryer për këtë pasuri rezulton se subjekti ka deklaruar saktë gjendjen e pronës, ka pasur mundësi financiare të ligjshme dhe të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie dhe subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit me palën shitëse.

36. Llogari rrjedhëse në “Credins Bank”³⁰ në vlerën 800,334 lekë, 100% në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhura nga paga e subjektit dhe mësimdhënia.

Hetimi³¹ dhe arsyetimi juridiko-financiar i kryer nga Komisioni

36.1. Nga hetimi ka rezultuar se kjo llogari është përdorur si llogari page në emër të subjektit prej viti 2010 e në vazhdim. Nga nxjerrja e llogarisë të pagës së subjektit në “Credins Bank” rezulton se gjendja e saj në datën 24.1.2017 ka qenë në vlerën 800,334 lekë.

Tabela nr. 7.³²

	Viti 2015	Viti 2016
Pasuria	1,454,089.03	627,229.80
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>1,454,089.03</i>	<i>627,229.80</i>
Detyrime	0.00	0.00
Pasuria neto	1,454,089.03	627,229.80
Të ardhura	2,711,791.19	2,451,697.65
Të ardhurat e subjektit	1,102,810.00	1,096,008.00
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit	1,144,785.00	1,077,241.00
Të ardhura nga interesa bankare nga depozita	31,494.50	24,584.12
Të ardhura nga interesa bankare nga bono thesari	336,346.69	159,175.53
Të ardhurat nga honoraret	96,355.00	94,689.00

³⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie nga “Credins Bank” datë 17.10.2016 dhe datë 19.1.2017.

³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 22.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.3.2020, e “Credins Bank”.

³² Analiza për gjendjen e llogarisë rrjedhëse në “Credins Bank” në vlerën 800,334 lekë.

Shpenzime	1,299,835.24	1,444,409.40
Shpenzime jetike	897,104.00	940,368.00
TIMS	350,424.24	236,206.80
TIMS mbuluar nga honoraret	52,307.00	51,402.60
Shpenzime për shkollim në shkollën “T.O” 50% bursë	0.00	216,432.00
Mundësia për kursime	-42,133.08	380,058.46

36.2. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të krijuar këtë gjendje në llogarinë e pagës.

37. Depozitë pa afat në “Credins Bank”³³ në vlerën 1,221,657 lekë, 100% në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes

Burimi sipas deklaratës Vetting: të ardhura nga paga e subjektit dhe mësimdhënia.

Hetimi³⁴ dhe arsyetimi juridiko-financiar i kryer nga Komisioni

37.1. Nga nxjerrja e llogarisë së pagës të subjektit në “Credins Bank” rezulton se gjendja e saj në datën 22.5.2012 ka qenë në vlerën 1,066,434.73 lekë.

Në datën 22.5.2012 subjekti ka çelur depozitë me afat 12 muaj në shumën 1,050,000 lekë, të lidhur me këtë llogari. Depozita ka vijuar në vitet në vazhdim dhe gjendja e saj në datën 24.1.2017 ka qenë në vlerën 1,221,657 lekë, e cila përputhet me deklarin e subjektit në deklaratën Vetting.

37.2. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite.

Tabela nr. 8.³⁵

	Datë 22.5.2012
Pasuria	-1,055,487.46
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>-1,055,487.46</i>
Detyrime	0.00
Pasuria neto	-1,055,487.46
Të ardhura	1,281,019.13
Të ardhurat e subjektit	452,494.94
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit	518,325.83
Të ardhura nga interesa bankare nga bono thesari	289,240.36
Të ardhura nga honoraret	20,958.00
Shpenzime	957,607.31

³³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie datë 14.10.2016 të “Credins Bank”.

³⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 22.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.3.2020, e “Credins Bank”.

³⁵ Analizë financiare për depozitë pa afat në “Credins Bank” në vlerën 1,221,657 lekë.

Shpenzime jetike	232,580.00
TIMS	378,457.31
TIMS mbuluar nga honoraret	20,958.00
Mundësia për kursime	1,378,899.28

38. Llogari rrjedhëse në “Intesa Sanpaolo Bank”³⁶ (investuar edhe në bono thesari) në vlerën 4,822,242 lekë, 100% në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes

Hetimi³⁷ dhe arsyetimi juridiko-financiar i kryer nga Komisioni

38.1. Bazuar në nxjerrjen e llogarisë së subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank” rezulton se në datën 25.1.2008 në llogarinë rrjedhëse subjekti Albert Meça ka depozituar shumën 1,000,000 lekë, nën komentin “cash deposit nga A. M për bono thesari”. Kjo shumë e ka burimin nga tërheqja prej 1,000,000 lekësh e kryer në datën 25.1.2008 nga subjekti në llogarinë e tij të pagës në “Raiffeisen Bank”, në të cilën ka pasur gjendje shumën 1,129,792.09 lekë në datën 31.12.2007.

38.2. Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 243,694.51 lekë për të krijuar gjendjen në banka dhe për të mbuluar shpenzimet dhe për këtë iu kalua barra e provës.

38.3. Pas kalimit të barrës së provës subjekti ka prapësuar³⁸ se:

- i. Shuma e shlyerjes së kredisë bankare e pasqyruar në tabelën e rezultatit të hetimit është 636,443 lekë, konvertim i shumës 5,166 euro, ndërkohë që sipas të dhënave të *statement-it* të “Intesa Sanpaolo Bank” për llogarinë rrjedhëse në euro kjo shumë për vitin 2007 duhet të jetë 471,549 lekë, konvertim i shumës 3,900 euro.
- ii. Nga të dhënat e *statement-it* bankar të bankave “Raiffeisen Bank” dhe ProCredit Bank” shuma e të ardhurave të bashkëshortes është 1,138,512.00 lekë.
- iii. Në shpenzimet e sistemit TIMS, mbuluar nga honoraret shuma 73,755.10 lekë, nuk duhet të përfshihet në zërin “shpenzime”, për arsye se shuma 1,616.67 euro (konvertuar në 195,471.00 lekë) është pagesë e dhënë nga Ambasada Britanike subjektit Albert Meça për botimin e manualit “Marrëveshja e përkohshme Shqipëri-BE”, botuar në Shqipëri dhe nuk ka pasur shpenzime udhëtimi apo qëndrimi.

38.4. Komisioni, pasi shqyrtoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, vlerëson se:

- i) Në lidhje me shlyerjen e kredisë bankare, bazuar në *statement-in* e depozituar nga subjekti, në analizën financiare duhet të reflektohet ndryshimi i pretenduar nga subjekti për vitin 2007, duke u marrë në konsideratë vlera 3,900 euro.
- ii) Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes, në analizë financiare do të reflektohen vlerat e rezultuara nga *statement-i* bankar, të cilat, në rastin konkret, janë 1,138,512.00 lekë.
- iii) Ndërkohë, në lidhje me shpenzimet e udhëtimeve, Komisioni nuk do të pranojë pretendimin e subjektit, pasi udhëtimet e kryera prej tij janë nxjerrë nga sistemi TIMS dhe nuk lidhen me veprimtaritë e kryera nga ana e tij në Shqipëri, prej të cilave mund të ketë përfituar të ardhura ku përfshihet dhe botimi i materialeve të ndryshme.

³⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie nga “Intesa SanPaolo Bank”, datë 10.1.2017.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 22.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.2.2020, e ISP-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 29.1.2020, e “Raiffeisen Bank”.

³⁸ Për më shumë shihni shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti në datën 7.7.2022.

38.5. Në përfundim, pasi u përfshinë në analizë financiare pretendimet e subjektit, rezultoi se rezultati negativ është në vlerën rreth 21,000 lekë, e cila është e papërfillshme për t'u marrë në konsideratë nga Komisioni.

Për pasojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

38.6. Në datën 31.1.2008 subjekti ka blerë kuota bono thesari në vlerën 1,000,000 lekë, me datë maturimi 14.11.2013. Në datën 7.10.2011 subjekti ka transferuar 2,000,000 lekë nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank” në llogarinë rrjedhëse në “Intesa Sanpaolo Bank” për blerjen e bonove të thesarit në shumën 2,000,000 lekë. Kjo shumë e ka burimin nga transferimi i shumës 1,500,000 lekë nga llogaria e bashkëshortes në “Raiffeisen Bank” në datën 6.10.2011 dhe gjendja në shumën 500,000 lekë që subjekti ka pasur në këtë llogari.

Tabela nr. 9.³⁹

	Datë 7.10.2011
Pasuria	772,343.19
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>772,343.19</i>
Detyrime	0.00
Pasuria neto	772,343.19
Të ardhura	3,002,874.16
Të ardhurat e subjektit	823,222.50
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit	882,608.33
Të ardhura nga interesa bankare nga bono thesari	344,778.68
Të ardhurat nga honoraret	952,264.65
Shpenzime	1,060,940.54
Shpenzime jetike	455,400.00
TIMS	230,945.54
TIMS mbuluar nga honoraret	283,515.00
Mundësia për kursime	1,169,590.43

Shtesat⁴⁰ në llogarinë e subjektit në bono thesari kanë si burim të ardhurat nga paga dhe pas maturimit periodik gjendja e llogarisë bono thesari në datën 24.1.2017 është në vlerën 4,822,242 lekë.

38.7. Nga kryerja e analizës financiare konkludohet se subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

39. Llogari bankare (investuar edhe në bono thesari) në “Intesa Sanpaolo Bank” në vlerën 6,368,633 lekë, në emër të bashkëshortes së subjektit M.M

Burimi sipas deklaratës Vetting: paga si punonjëse në Kryeministri dhe të ardhurat nga mësimdhënia.

Hetimi⁴¹ dhe arsyetimi juridiko-financiar i kryer nga Komisioni

39.1. Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes së subjektit në ISP Bank rezultoi se:

³⁹ Analiza e pjesshme financiare për fonde të investuara në bono thesari në vitin 2011.

⁴⁰ Referuar tabelës në analizën financiare.

⁴¹ Shkresë nr. *** prot., datë 22.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.2.2020, e ISP Bank; shkresë kthim përgjigjeje nr.*** prot., datë 29.1.2020, e “Raiffeisen Bank”.

i. Në datën 10.9.2007 është depozituar shuma 1,000,000 lekë, e cila është përdorur si burim për blerjen e kuotave në bono thesari në datën 13.9.2007.

Burimi i kësaj shume është tërheqja e kryer nga bashkëshortja e subjektit në po të njëjtën datë në llogarinë e saj të pagës në “Raiffeisen Bank”.

ii. Në datën 1.2.2010 bashkëshortja e subjektit ka depozituar *cash* nën komentin “kursime paga” shumën 1,000,000 lekë. Gjendja e llogarisë në datën 4.2.2010 ka qenë 1,055,706.74 lekë, nga të cilat znj. M. M ka blerë kuota për bono thesari në vlerën 1,000,000 lekë. Pas maturimit të tyre gjendja në llogari në datën 18.11.2010 ka qenë 1,066,484.76 lekë. Bashkëshortja e subjektit në këtë datë ka blerë kuota bono thesari në vlerën 1,000,000 lekë.

Tabela nr. 10.⁴²

	Datë 1.2.2010
Pasuria	-861,490.19
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>-861,490.19</i>
Detyrime	-14,982.50
Kredia bankare BIA 20,000 euro më 26.4.2004	0.00
Shlyerje e kredisë bankare	-14,982.50
Pasuria neto	-846,507.69
Të ardhura	167,610.17
Të ardhurat e subjektit	77,100.17
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit	90,510.00
Shpenzime	45,540.00
Shpenzime jetike	45,540.00
Mundësia për kursime	968,577.85

Nga analiza financiare rezulton se bashkëshortja e subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj llogarie.

iii. Gjendjet e krijuara në këtë llogari janë përdorur si burim për shtesat në llogarinë e bashkëshortes së subjektit në bono thesari.

Pas maturimit periodik gjendja e llogarisë bono thesari në datën 24.1.2017 rezulton në vlerën 6,368,633 lekë.

39.2. Nga hetimi duket se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë investuar ndër vite në llogari bankare (investim në bono thesari) në “Intesa Sanpaolo Bank”. Burimi i krijimit të këtyre llogarive kanë qenë të ardhurat nga paga dhe shtesat e fondeve në bono thesari janë kryer kryesisht nga llogaritë e pagave.

39.3. Nga analiza financiare duket se subjekti nuk pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e investimeve në bono thesari dhe shlyerjen e kredisë⁴³ në vlerë kumulative ndër vite prej 544,023.12 lekësh dhe për këtë iu kalua barra e provës.

39.4. Në lidhje me këtë rezultat të hetimit, subjekti ka prapësuar⁴⁴ si më poshtë vijon:

Në analizën financiare të vitit 2013

⁴² Analiza financiare e çeljes së llogarisë bankare (investuar edhe në bono thesari) në “Intesa Sanpaolo Bank”.

⁴³ Kredia është shlyer në vitin 2010.

⁴⁴ Për më shumë shihni shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti në datën 7.7.2022.

i) Nga *statement*-i i llogarive bankare në emër të z. Albert Meça në “Credins Bank” dhe “ProCredit Bank” shuma e të ardhurave të tij duhet të jetë 1,329,776.00 lekë.

ii) Nga *statement*-i i llogarive bankare të “Intesa Sanpaolo Bank”, “Union Bank” dhe “Tirana Bank” shuma e të ardhurave të bashkëshortes duhet të jetë 1,308,500.00 lekë.

iii) Subjekti ka sqaruar se sipas rregullores për mbulimin e shpenzimeve të ekspertëve të KE-së, ekspertit i paguhen shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e qëndrimit. Shpenzimet e udhëtimit rimburohen si zë më vete sipas parashikimeve të rregullores ose parapaguhet nga KE-ja, ndërsa shpenzimet e qëndrimit janë me një dietë ditore që ka filluar (në vitin 2000) 160 euro/ditë dhe aktualisht (sipas ndryshimeve të fundit të rregullores) janë 175 euro/ditë. Për pasojë, subjekti ka kërkuar që shuma TIMS e mbuluar nga honoraret të korrigojohet nga 60,290.30 lekë në 34,730.12 lekë.

Në analizën financiare të vitit 2014

i) Nga *statement*-i i llogarive bankare në “Credins Bank” shuma e të ardhurave të tij duhet të jetë 1,190,462.00 lekë.

ii) Nga *statement*-i i llogarive bankare në “Union Bank”, “Credins Bank”, “Intesa Sanpaolo Bank” dhe “ProCredit Bank” shuma e të ardhurave të bashkëshortes duhet të jetë 1,393,012.00 lekë.

iii) Të ardhurat nga interesa bankare bono thesari duhet të korrigojohet nga 257,236.14 lekë në 290,000.00 lekë.

iv) Subjekti ka pretenduar se në zërin TIMS mbuluar nga honoraret të zbritet shuma 25,219.80 (konvertim i vlerës 180 euro), të parashikuara si shpenzime bilete udhëtimi, pasi të ardhurat nga honoraret në vitin 2014 në shumën 110,266.57 lekë (konvertim i vlerës 787 euro) janë vetëm për shpenzimet e qëndrimit të bashkëshortes në udhëtimin për qëllime pune në KE (Strasbourg) dhe nuk përfshijnë shpenzimet e udhëtimit.

Në analizën financiare të vitit 2015

i) Nga *statement*-i i llogarive bankare në “Intesa Sanpaolo Bank”, “ProCredit Bank” dhe “Tirana Bank” shuma e të ardhurave të bashkëshortes së tij duhet të jetë 1,348,878.00 lekë.

ii) Subjekti ka pretenduar që në zërin TIMS mbuluar nga honoraret të zbritet shuma 31,647.80 (konvertim i vlerës 230 euro).

39.5. Komisioni, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit dhe provat e depozituara prej tij, çmon se në lidhje me të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes në analizë financiare do të reflektohen vlerat e rezultuara nga *statement*-i bankar përkatës, pasi tregojnë situatën faktike të këtyre të ardhurave dhe jo ato të pasqyruara në vërtetimet e depozituar nga subjekti së bashku me deklaratën *Vetting*. Ndërkohë, në lidhje me pretendimin e subjektit për udhëtimet, nuk do të pranohet nga Komisioni.

39.6. Pas reflektimit të ndryshimeve, analiza financiare për krijimin e bonove të thesarit dhe shlyerjen e kredisë në vitet 2007 - 2016 rezulton pozitive, për rrjedhojë, subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e bonove të thesarit dhe pagesë të kredisë, duke rezultuar me një rezultat pozitiv për këtë periudhë në vlerën 4,300,000 lekë.

Në përfundim, konkludohet se subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këto pasuri.

40. Llogari rrjedhëse në vlerën 2,067 euro në “Intesa Sanpaolo Bank”⁴⁵, 100% në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes së tij

⁴⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* nxjerrje llogarie datë 10.1.2017, nga ISP Bank.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhura nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes.

Hetimi⁴⁶ dhe arsyetimi juridiko-financiar i kryer nga Komisioni

Bazuar në nxjerrjen e llogarisë së subjektit dhe bashkëshortes në ISP Bank rezulton se në datën 5.5.2004, në llogarinë dyemërore nr. *** në euro, është kryer disbursimi i kredisë në vlerën 20,000 euro. Kjo llogari ka shërbyer si llogari rrjedhëse prej vitit 2005 për shlyerjen e kredisë në vitet 2005 - 2011. Gjendja e kësaj llogarie në datën 24.1.2017 ka qenë 2,0670 euro.

Komisioni nuk ka konstatuar ndonjë paqartësi apo pasaktësi në këtë llogari.

41. Llogari bankare në “Credins Bank”, 100% në pronësi të vajzës së subjektit G.M

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: Bashkia Tiranë si nxënëse shembullore.

Hetimi⁴⁷ dhe arsyetimi juridiko-financiar i kryer nga Komisioni

Nga hetimi rezulton se kjo llogari është hapur në vitin 2014 dhe në të janë kryer depozitime në emër të G.M nën komentin “dhënie stimuli nxënës me 10-ta” nga Bashkia Tiranë. Gjendja e kësaj llogarie në datën 24.1.2017 është 15,000 lekë.

Komisioni nuk ka konstatuar ndonjë parregullsi në këtë llogari.

PASURITË E BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT

42. Apartament⁴⁸ me sipërfaqe 58 m², i ndodhur në lagjen “29 Nëntori”, p. ***, shk. **, kati **, ap. **, Elbasan, i regjistruar në vol. *, f. ***, z. k. ***, me nr. pasurie ***, 75% në pronësi të bashkëshortes së subjektit dhe 25% në pronësi të vëllait të saj E.Z. Shuma e paguar për privatizimin është 5,330 lekë.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: Përfitur nga privatizimet e vitit 1992 dhe nga trashëgimia ligjore e babait Ç.Z.

Hetimi⁴⁹ dhe arsyetimi juridiko-financiar i kryer nga Komisioni

42.1. Me kontratën e privatizimit të datës 17.8.1993, babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit ka privatizuar nga Ndërmarrja Komunale Banesa apartamentin me sip. 58 m², ndodhur në lagjen “*** Nëntori”, Elbasan. Sipas mandatarkëtimit që i bashkëlidhet kontratës së shitjes rezulton se blerësi Ç.Z ka paguar në favor të Ndërmarrja Komunale Banesa vlerën prej 5,330 lekësh. Pasuria është regjistruar në pronësi të shtetasve Ç.Z dhe M.Z, anëtarët madhorë të familjes Z në datën e privatizimit të apartamentit.

42.2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 23.9.2009, ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerin Ç.Z⁵⁰, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të tij fëmijët E e M.Z(M) të cilët trashëgojnë në mënyrë të barabartë ½ pjesë secili të të drejtave dhe detyrimeve të pasurisë trashëgimore.

Bazuar mbi këtë dëshmi trashëgimie, apartamenti me sip. 58 m², i ndodhur në lagjen “*** Nëntori” Elbasan, është regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve M.Z e cila zotëron ¾ pjesë takuese të pasurisë dhe shtetasit E.Z i cili zotëron ¼ pjesë takuese të pasurisë.

⁴⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 22.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.2.2020, e ISP Bank.

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 22.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.3.2020, e “Credins Bank”.

⁴⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) kartelë pasurie të apartamentit me sip. 58 m²; dhe (ii) vendim gjykate nr. ***, datë 23.9.2009, për çelje trashëgimie.

⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.11.2021, dërguar ASHK-së Drejtoria Vendore Elbasan; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.11.2021, e ASHK-së Drejtoria Vendore Elbasan.

⁵⁰ Referuar përmbajtjes së vendimit për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, i ndjeri Ç.Z ka ndërruar jetë më 22.4.2000.

42.3. Bashkëshortja e subjektit e ka deklaruar pronësinë e këtij apartamenti në DPV/2003, ku ajo ka deklaruar për shkak të funksionit të saj si “juriste” pranë Departamentit Juridik në Kryeministri. Në këtë DPV ajo e deklaroi pasurinë me përshkrimin “shtëpi banimi lagjja ‘** Nëntori’ Elbasan, me vlerë 2,500,000 lekë, pjesë takuese 75%, me burim trashëgiminë ligjore”. Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi që të ketë deklaruar këtë pasuri në deklaratën e pasurisë të vitit 2003.

Subjekti, në lidhje me këtë apartament, në përgjigje të pyetësorit të datës 4.3.2022, ka deklaruar se përdoret nga vëllai i bashkëshortes së tij.

Në përfundim konkludohet se subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

KONSTATIME TE TJERA

43. Automjet tip “Volkswagen Golf”, me vlerë 250,000 lekë, deklaruar nga subjekti në DPV/2003

43.1. Sipas dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRR-ja⁵¹ rezultoi se me kontratën e shitjes nr. ***, datë 31.12.2002, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin tip “Volkswagen Golf” (vit prodhimi 1989) në shumën 250,000 lekë nga shitësi Xh.C. Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, pagesa e çmimit të shitjes në favor të shitësit është kryer jashtë zyrës noteriale.

43.2. Sipas dokumentacionit të administruar rezultoi se shitësi Xh.C e ka blerë këtë automjet në shtetin gjerman në datën 11.12.2002 në vlerën 1,000 euro. Referuar deklaratës doganore Import *, në datën 27.12.2002 ai ka paguar zhdoganimin në vlerën 150,600 lekë. Pra, në total, shitësi Xh.C ka paguar shumën 287,400 lekë për blerjen e këtij automjeti.

43.3. Sipas dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRR-ja rezultoi se me kontratën e shitjes nr. ***, datë 27.4.2006, subjekti i rivlerësimit e ka shitur këtë automjet në vlerën 210,000 lekë⁵², e cila është likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale.

43.4. I pyetur në lidhje me çmimin e blerjes, si dhe me marrëdhënien me shitësin e këtij automjeti, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit datë 4.3.2022, ka deklaruar: *“Me shtetasin Xh.C nuk kam pasur asnjë njohje të mëparshme dhe as kam ndonjë lidhje me të. Jam takuar vetëm një herë në dhjetor 2002 gjatë procedurave për blerjen e automjetit tip ‘Golf’. Automjetin e kam blerë në tregun e makinave të përdorura në Durrës. Çmimi është dakordësuar midis shitësit dhe blerësit sipas tregut të lirë dhe i pasqyruar edhe në kontratën përkatëse. Pas blerjes kam kryer disa shërbime dhe riparime me vlerë 15.000 - 20.000 lekë, i kam zëvendësuar gomat me të reja, si dhe procedurat për targimin e tij dhe pajisjen me dokumentacionin e nevojshëm. Veç sa më sipër, nga dosja e automjetit me targë TR ***F të DRSHTRR-së Tiranë rezultoi se vlera totale e paguar për zhdoganimin e këtij mjete është 150,600 lekë dhe jo 287,400 lekë, fakti i provuar me dokument zhdoganimi datë 27.12.2002, të cilin po e bashkëlidh në dokumentacionin në përgjigje të këtij pyetësori. Duke marrë parasysh sa më sipër, si edhe faktin se sipas legjislacionit gjerman shitësi do të rimbursohej në Gjermani në vlerën 19 % TVSH, (afërsisht shuma 190 euro), rezultoi se automjeti nuk është blerë me vlerë më të ulur. Në dijeninë time nuk kam gjykuar asnjë çështje ku z. Xh.C të jetë palë”.*

43.5. Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes së tij përgjigjet e institucioneve në të cilat ka ushtruar detyrën, të cilat konfirmojnë se A. M nuk ka gjykuar çështje me palë ndërgjyqëse shtetasin Xh.C, si vijon:

- shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.3.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;

⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 7.12.2021, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.12.2021, e DPSHTRR-së.

⁵² Deklaruar në DPV/2006.

- shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.3.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (Dhoma Civile);
- shkresë kthim përgjigjeje nr. ekstra prot., datë 11.3.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (Dhoma Penale).

43.6. Analiza financiare për automjetin tip “Volkswagen Golf”

Tabela nr. 11.⁵³

	Datë 31.12.2002
Pasuria	250,000.00
Automjet “Volkswagen Golf”	250,000.00
<i>Ndryshim likuiditeti (shtesa/pakësime)</i>	
Detyrime	0.00
Pasuria neto	250,000.00
Të ardhura	1,091,402.00
Të ardhurat e subjektit	506,514.00
Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit	584,888.00
Shpenzime	725,682.00
Shpenzime jetike	281,682.00
TIMS	0.00
Shpenzime qiraje për banim	144,000.00
Shpenzime mobilimi	300,000.00
Mundësia për kursime	115,720.00

Nga analiza financiare duket se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie.

44. Dhurim i vlerës 600,000 lekë nga prindërit e subjektit dhe nëna e bashkëshortes së tij, deklaruar në pyetësin standard

Subjekti ka deklaruar në DPV/2004 se ka përfituar dhuratë shumën 600,000 lekë nga prindërit e tij dhe të bashkëshortes.

44.1. Ky dhurim është deklaruar edhe në pyetësin standard, ku si burim janë deklaruar kursimet e tyre nga puna ndër vite, duke bashkëlidhur:

i. Deklaratë noteriale nr. ***, datë 3.2.2020, të babait të tij F.M, në përmbajtje të së cilës deklarohet se në fillim të vitit 2004 i ka dhuruar djalit të tij shumën 300,000 lekë me rastin e blerjes së shtëpisë. Si burim për krijimin e kësaj shume ai deklarohet punën e kryer ndër vite si avokat, jurist dhe drejtues i ndërmarrjeve shtetërore dhe bizneseve private.

ii. Deklaratë noteriale nr. ***, datë 5.2.2020, e shtetasës N.Xh, në përmbajtje të së cilës deklarohet se në vitin 2004 i ka dhënë vajzës së saj M.M shumën prej 300,000 lekësh si dhuratë për shtëpinë e re. Këtë shumë, znj. Xh deklarohet se e ka pasur pjesë të të ardhurave të përfituara nga puna në shtetin grek nga viti 1998 e në vijim.

44.2. Për të vërtetuar të ardhurat e shtetasës N.Xh, të cilat kanë shërbyer si burim i ligjshëm për dhurimin e shumës 300,000 lekë, subjekti ka depozituar dokumentin⁵⁴ “Ilogaria e të siguarit N.Xh”, datë 26.9.2019, lëshuar nga ***, A.U.S.Sh.G.

⁵³ Analizë financiare për automjetin tip “Volkswagen Golf”.

⁵⁴ Dokumenti është paraqitur i përkthyer dhe i pajisur me vulë apostile.

Sipas këtij dokumenti vërtetohen të ardhurat e znj. Xh për vitin 2003 në shumën 1,118.16 euro, si dhe të ardhura për periudhën janar – prill të vitit 2004 në shumën 500.86 euro.

Komisioni ka vlerësuar të mos përfshijë në analizë financiare shumën 300,000 lekë të dhuruar nga shtetasja N.Xh, pasi duket se të ardhurat e evidentuara nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti rezultojnë të pamjaftueshme për të mbuluar dhurimin e kësaj shume prej në favor të subjektit dhe të bashkëshortes së tij. Për këtë rezultat të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës.

44.3. Në lidhje me këtë barrë prove⁵⁵ subjekti ka prapësuar në DPV/2004 dhe në pyetësorët e këtij procesi se *në vitin 2004 ka marrë shumën 300,000 lekë nga nëna e bashkëshortes N.Xh. Shuma e mësipërme është e ardhur e ligjshme dhe e fituar nga puna e saj ndër vite, sidomos në Greqi, ku ajo punon dhe jeton që nga viti 1998 e në vijim.*

Fakti i dhënies së kësaj shume dhe burimi i ligjshëm i saj provohet me:

- Dokument “Ilogaria e të siguruarit N.Xh”, datë 26.9.2019, lëshuar nga ***, A.U.S Sh. Ky dokument zyrtar provon faktin se shtetasja N.Xh punon dhe paguan rregullisht sigurimet shoqërore në shtetin grek që prej datës 17.7.2000, me nr. *** të sigurimeve shoqërore, etj. Dokumenti i mësipërm përmban të dhënat sipas regjistrave elektronikë të sigurimeve shoqërore nga viti 2002, pasi para kësaj periudhe regjistrat grekë janë mbajtur në formë joelektronike dhe nuk gjenerojnë të dhënat e tyre.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., ** kol., datë 5.2.2020, e shtetases N.Xh, me anë të së cilës rezulton se deklaruesja i ka dhënë vajzës së saj shumën 300,000 lekë në vitin 2004 dhe burimi i saj kanë qenë nga puna në emigracion që nga viti 1998 e në vijim.
- Leje qëndrimi dhe librezë personale shëndeti e shtetases N.Xh.
- Vërtetim i dhënies së NIPT-it i Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve Tatimore Athinë, Greqi, në lidhje me shtetasen N.Xh, me anë të të cilit vërtetohet se kjo shtetase, sipas deklaratës nr. ***, datë 17.7.2000, i është dhënë NIPT me nr. *** si tatimpaguese, pra, ka qenë e punësuar dhe ka paguar detyrimet tatimore minimalisht që nga data 17.7.2000.
- Njoftim i pagesës së taksave i *** (I. P.A.P) Greqi në lidhje me shtetasen N.Xh, i cili konfirmon vazhdimësinë e pagimit të taksave dhe tatimeve.
- Deklaratë e Institucionit të të Ardhurave Publike Greqi për të dhënat informuese mbi qiranë dhe faturën e pagimit të energjisë elektrike për shtetasen N.Xh, e cila provon se nëna e bashkëshortes jeton në Greqi dhe ka paguar rregullisht edhe detyrimet për strehim dhe energji elektrike.

Subjekti pretendon se nga provat e mësipërme rezulton e provuar se nëna e bashkëshortes punon rregullisht në shtetin grek minimalisht që nga data 17.7.2000, kur ka marrë NIPT-in me nr. **** si tatimpaguese; rezulton si paguese kontributesh të sigurimeve shoqërore me nr****; figuron si paguese e sigurimeve shëndetësore dhe ka leje qëndrimi të rregullt prej vitit 2000. Pavarësisht sa më sipër, në mënyrë indirekte, provohet fakti se shtetasja N.Xh ka punuar dhe ka siguruar të ardhura të ligjshme që nga viti 2000, pasi numri *** i sigurimeve shoqërore dhe numri *** personal figurojnë të regjistruar që në vitin 2000. Është fakt i njohur botërisht se leja e qëndrimit në një vend anëtar të Bashkimit Europian si Greqia i jepet një shtetasi që provon jo vetëm qëndrimin në mënyrë të ligjshme në këtë shtet, por edhe punësimin e tij/saj dhe mundësinë për të pasur të ardhura të ligjshme.

⁵⁵ Për më shumë shihni shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti në datën 7.7.2022.

44.4. Komisioni pasi shqyrtoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, vlerëson se ka *indicie* për mundësinë financiare të dhurimit të shumës 300,000 nga nëna e bashkëshortes së subjektit, por ai nuk arriti të provojë qartësisht, bazuar në dokumentacion, të ardhurat e siguruar nga ana e saj, në mënyrë që Komisioni të mund të kryente një analizë financiare për mundësinë e kursimit. Në këto kushte, pavarësisht se provohet me dokumentacion punësimi dhe pagimi i tatimeve nga dhuruesja, çmohet se nuk provohet aftësia për kursim e dhurimit të shumës prej 300,000 lekësh në vitin 2004. Në lidhje me këtë shumë, Komisioni vlerëson se ajo nuk ka ndikim në analizën financiare të subjektit, pasi rezultati negativ në vitin 2004 është në vlerën 209,208 lekë, vlerë e cila nuk mund të shërbejë si shkak për marrjen e masës së shkarkimit për subjektin e rivlerësimit.

44.5. Për të vërtetuar të ardhurat e shtetasve F dhe M.M, të cilat kanë shërbyer si burim i ligjshëm për dhurimin e shumës 300,000 lekë, subjekti ka depozituar:

- i. vërtetim nr. *** prot., datë 5.10.2020, i Bashkisë Krujë, ku konfirmohen pagesat e përfituara nga shtetasi F.M në vitin 2003 si kryetar i KZQV-së, si dhe listëpagesat përkatëse;
- ii. vendim për caktim pensioni nr. **, datë 1.11.2000, nga ISSH-ja, ku evidentohet pensioni i përfituar nga shtetasi F.M nga data 1.7.2000, në vlerë mujore 20,615 lekë;
- iii. vërtetim nga ISSH mbi pagën *neto* të përfituar nga shtetasi F.M për periudhën 1.1.1994 – 2000, në shumën totale 822,728 lekë;
- iv. vendim për caktim pensioni nr. ***, datë 2.14.2007, nga ISSH-ja, ku evidentohet pensioni i përfituar nga shtetasja M.M nga data 1.10.2005;
- v. librezë pune dhe librezë kontributesh e shtetasës M.M.

44.6. Bazuar në dokumentacionin e mësipërm, Komisioni kreu analizën financiare mbi mundësinë e prindërve të subjektit të rivlerësimit për dhurimin e shumës 300,000 lekë në vitin 2004. Në këtë analizë janë përfshirë të ardhurat e ligjshme të dokumentuara, ndërsa shpenzimet jetike janë përlllogaritur në masën 66%⁵⁶.

Tabela nr. 12.⁵⁷

	Kumulative 1994 – prill 2004
Total i të ardhurave F. Meça	1,936,923.00
Vërtetim nr. **, i Bashkisë Krujë si zv/kryetar i KZZ	21,600.00
ISSH paga “H” sh.p.k.	190,755.00
Asistencë	25,800.00
ISSH paga “I” sh.p.k.	606,173.00
Pension pleqërie korrik 2000 – janar 2021	1,092,595.00
Të ardhurat e M.M	-
Të ardhurat totale	1,936,923.00
Shpenzimet jetike 0.66 për vitet 1994 - 2000	1,318,078.72
Mundësia për kursime	618,844.28

44.7. Nga analiza financiare rezulton se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhurimin e shumës 300,000 lekë. Si rrjedhojë, kjo shumë është përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

45. Apartament me sip. 65.62 m², ndodhur në Krujë, regjistruar në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij përmes dëshmisë së trashëgimisë datë 20.10.2021

⁵⁶ Vendim nr. 11, datë 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁵⁷ Analiza financiare mbi mundësinë e prindërve të subjektit të rivlerësimit për dhurimin e shumës 300,000 lekë në vitin 2004.

Hetimi⁵⁸ dhe arsyetimi juridiko-financiar i kryer nga Komisioni

45.1. Nga kërkimi në portalin elektronik të ASHK-së rezultoi se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij është regjistruar pasuria apartament me sip. 65.62 m², ndodhur në rrugën “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” Krujë, regjistruar me nr. pasurie ***.

45.2. Me kontratën e shitjes datë 11.6.1993, babai i subjektit të rivlerësimit F.M ka blerë nga Ndërmarrja Komunale e Banesave Krujë apartamentin me sip. 65.62 m², ndodhur në lagjen nr. *, me vlerë 7,655 lekë. Pagesa provohet me mandatarkëtimin nr. **, datë 29.5.1993. Apartamenti fillimisht ka qenë i regjistruar në bashkëpronësi të subjektit, prindërve dhe gjyshes së tij, secili me ¼ pjesë takuese. Në datën 3.5.2002, me vendimin nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë është vendosur lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerën S.M (gjyshja e subjektit të rivlerësimit), duke u caktuar si trashëgimtarë të radhës së parë fëmijët e saj.

Në datën 24.5.2002 subjekti, së bashku me nënën e tij dhe trashëgimtarët e tjerë të së ndjerës S.M, me deklaratën noteriale nr. *** kanë hequr dorë nga bashkëpronësia e këtij apartamenti në favor të babait të subjektit. Pas heqjes dorë të bashkëpronarëve apartamenti është regjistruar në pronësi të shtetasit F. M, i cili në datën 7.6.2002 është pajisur dhe me certifikatë pasurie.

45.3. Në datën 17.2.2021 i ndjeri F.M ka ndërruar jetë dhe në datën 20.10.2021 është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore nr. ***, sipas së cilës, trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të z. M janë caktuar bashkëshortja e tij M.M dhe dy djemtë A.M dhe E.M, të cilët trashëgojnë përkatësisht 1/3 pjesë të pasurisë trashëgimore.

45.4. Në datën 21.10.2021 vëllai i subjektit E.M ka regjistruar dëshminë e trashëgimisë në ASHK. Mbi bazën e kësaj dëshmie, apartamenti me sip. 65.62 m² është regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve M.M, A.M dhe E.M të cilët kanë përfituar përkatësisht 1/3 pjesë të kësaj pasurie.

45.5. Komisioni vlerëson se nuk paraqiten paqartësi apo dyshime në lidhje me këtë pasuri.

DETYRIME FINANCIARE

46. Huamarrje në vlerën 20,000 euro në Bankën Italo-Shqiptare (sot “Intesa Sanpaolo Bank”) për blerje apartamenti, me kontratë nr. ***, datë 28.4.2004, në shumën 20,000 euro, me kohëzgjatje 6 vjet. Kjo kredi rezulton të jetë disbursuar në llogarinë dyemërore të subjektit dhe bashkëshortes në datën 6.5.2004. Për garantimin e kësaj kontrate është vendosur si garanci hipotekore pasuria apartament me sip. 105 m², ndodhur në rrugën “M.Gj”, Tiranë.

Kjo kredi është trajtuar në analizimin e pasurisë apartament në pikën 26 të këtij vendimi.

47. Të ardhura/honorare nga angazhimet si ekspert i KE/USA, si dhe pjesëmarrje në trajnime, konferenca apo mbledhje të institucioneve apo organizatave të ndryshme ndërkombëtare

47.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura nga angazhimet si ekspert të KE/USA dhe trajnimet jashtë vendit të miat dhe të bashkëshortes në shumën 30,000 euro, si dhe 6,400 USD*”.

Nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore rezulton se subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara prej tij dhe bashkëshortes në trajnime, pjesëmarrje në konferenca etj.

Në lidhje me këto të ardhura, në pyetësorin e datës 4.3.2022, subjekti ka sqaruar: “*Në lidhje me pagesat e trajnimeve, konferencave apo mbledhje të institucioneve apo organizatave të ndryshme ndërkombëtare, ju bëj me dije se për shkak të kohës së kaluar (referuar legjislacioneve në bazë të të cilave funksionojnë këto entitete dokumentet arkivohen apo ruhen*

⁵⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 16.11.2021, drejtuar ASHK-së Drejtoria Vendore Krujë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.1.2022, e ASHK-së Drejtoria Vendore Krujë.

vetëm për një periudhë kohe të caktuar) dhe mënyrës si organizatorët kanë organizuar aktivitetet është e pamundur gjetja e të gjitha dokumenteve. Në çdo deklaratë vjetore janë deklaruar saktësisht shumat e marra nga unë dhe bashkëshortja ime”.

47.2. Për të provuar deklarinimin e tij, subjekti ka depozituar pranë Komisionit dokumentacion voluminoz në lidhje me pjesëmarrjen e tij dhe të bashkëshortes në trajnime dhe angazhimet si ekspert. Në vijim listohen të gjitha dokumentet e depozituara nga ana e tij nëpërmjet të cilave provohet përfitimi i të ardhurave (honorareve) nga trajnimet apo angazhimet si ekspert të tij dhe të bashkëshortes, si vijon:

- i. *Statement* bankar i llogarisë nr. *** në “Intesa Sanpaolo Bank” të subjektit dhe bashkëshortes, ku evidentohen pagesat e kryera me transfertat bankare, si më poshtë:
 - 29.7.2004 shuma 373 euro;
 - 16.7.2007 shuma 1,616 euro;
 - 13.12.2010 shuma 525 euro;
 - 9.8.2011 shuma 1,287 euro;
 - 24.12.2013 shuma 787 euro;
 - 5.11.2014 shuma 787 euro;
 - 3.11.2015 shuma 700 euro;
 - 30.11.2016 shuma 700 euro;
 - 30.11.2017 shuma 700 euro;
 - 20.11.2018 shuma 700 euro;
 - 19.11.2019 shuma 1,104 euro.
- ii. Për pagesat e kryera me çek bankar subjekti sqaron se disponon vetëm disa çek bankare, si më poshtë:
 - nr. ***, datë 9.10.2009, shuma 1,669 euro;
 - nr. ***, datë 14.10.2010, shuma 1,686 euro;
 - nr. ***, datë 28.3.2011, shuma 648 euro;
 - nr. ***, datë 30.3.2011, shuma 700 euro;
 - nr. ***, datë 11.1.2011, shuma 1,305.50 euro;
 - nr. ***, datë 18.11.2011, shuma 1,570 euro;
 - nr. *** datë 14.10.2011, shuma 1,375 euro.
- iii. Tabelë rimbursimi nr. ***, datë 25.7.2011, shuma 1,287 euro.
- iv. Certifikatë nr. ***, datë 3.10.2008, e Departamentit të Shtetit të SHBA, e cila provon pjesëmarrjen në programin *International Visitors* në SHBA dhe financimi ka qenë në shumën totale 9,825 USD.
- v. Shkresë datë 29.3.2005, e Këshillit të Ministrave (Njësia e Zbatimit të Projektit), shkresë nr. *** prot., datë 31.3.2005, e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave drejtuar Njesisë së Zbatimit të Projektit të Bankës Botërore, Nota Verbale nr. *** e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave drejtuar Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë dhe Formulari përkatës, provojnë faktin se shtetasja M.M ka marrë pjesë në Kursin e Institutit RIPA-s “*Translating Policy into Legislation*” të zhvilluar në Londër në datat 3-13 maj 2005. Shuma e paguar nga organizatorët ka qenë 3,200 euro.

Në total, subjekti dhe bashkëshortja tij në trajnime, pjesëmarrje në konferenca etj. për periudhën 2003 – 2016 rezultojnë se kanë përfituar të ardhura nga honoraret/dietat, si vijon:

- sipas deklaratave periodike vjetore shumat 22,963.00 euro dhe 12,316.00 USD;
- sipas dokumentacionit provues financiar më lart (transferta bankare/pagesa çek) në shumat 19,080.67 euro dhe 9,825.00 USD.

47.3. Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se dokumentacioni i depozituar nga subjekti ka qenë i plotë, ka vlerësuar të përfshijë në zërin “të ardhura” vetëm ato honorare/dieta për të cilat provohet përfitimi i tyre nëpërmjet sistemit bankar ose me dokumentacion provues sipas rregullave të organizatorëve. Në rastin kur nuk është provuar me dokumentacion marrja e tyre, ato janë zeruar me shpenzimet sipas dokumentacionit të depozituar nga subjekti.

47.4. Në lidhje me shpenzimet e udhëtimeve jashtë shtetit për arsye pune të subjektit dhe bashkëshortes së tij, Komisioni i është referuar llogaritjes së kryer si për çdo udhëtim tjetër sipas rregullave të përcaktuara nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimin nr. 11, datë 22.5.2019. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit për sa i përket mbulimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe akomodimit nga organizatorët, duke i përfshirë në këtë analizë.

47.5. Shuma e përfituara nga subjekti dhe bashkëshortja e tij nga honoraret dhe dietat pas zbritjes së shpenzimeve të udhëtimit, të llogaritura si më lart, është konsideruar si e ardhur vetëm në ato raste ku subjekti e ka deklaruar në deklaratat periodike. Në përfshirjen e kësaj shume si të ardhur është marrë në konsideratë fakti se: (i) në një pjesë të dokumentacionit të depozituar nga subjekti rezulton se shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe ushqimit janë mbuluar me një pjesë të dietës ose nga organizatorët; (ii) punonjësit e administratës që dërgohen me shërbim jashtë vendit bazuar në VKM-në nr. 870⁵⁹, datë 14.12.2011, përfitojnë një dietë për mbulimin e ushqimit në vlerën 60 euro/USD.

47.6. Për sa më sipër, në analizë financiare në zërin “të ardhura nga honorarët” është përfshirë shuma 3,449,481 lekë⁶⁰, ndërsa në zërin “shpenzime TIMS mbuluar nga honorarët” është përfshirë shuma 1,415,610 lekë.

47.7. Komisioni ka kryer edhe një analizë financiare alternative, ku shumat e përfituara nga të ardhurat nga honoraret është barazuar me shpenzimet TIMS mbuluar nga honoraret, pra nuk është konsideruar si e ardhur shuma e përfituar nga diferenca midis këtyre dy zërave.

Në këtë rast subjekti do të rezultonte më një rezultat negativ për të gjithë periudhën e rivlerësimit⁶¹ në vlerën 370,281 lekë, e cila nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkakut për marrjen e masës së shkarkimit ndaj subjektit të rivlerësimit.

48. Analiza financiare⁶²

Komisioni, pasi kreu analizë financiare, i kaloi subjektit barrën e provës për pamundësinë kumulative financiare, në total, prej fillimit të detyrës deri në deklaratën *Vetting* në shumën 930,829.41 lekë.

Në parashtrimet e tij subjekti ka pretenduar të pranohen sqarimet, argumentet dhe provat e paraqitura prej tij në lidhje me analizën financiare të viteve 2007, 2013, 2014 dhe 2015⁶³.

Bazuar në shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti, të analizuar më sipër në këtë vendim, analiza financiare e subjektit nga marrja e detyrës deri në deklaratën *Vetting* rezulton me një pamundësi financiare prej 231,203 lekësh, mbartur si rezultat i vitit 2004 në vlerën 209,208.15 lekë, në të cilin nuk është përfshirë dhurimi i shumës 300,000 lekë nga shtetasja N.

⁵⁹ Në VKM nr.304/2003 e ndryshuar e cila ka qenë në fuqi deri në vitin 2011 dieta ka qenë në vlerën 40 euro/USD

⁶⁰ Në mënyrë të detajuar, totali i të ardhurave nga honoraret dhe i shpenzimeve nga udhëtimet për arsye pune të subjektit është analizuar në tabelën nr. 15 të rezultateve të hetimit.

⁶¹ Viti 2005 do të kishte rezultat negativ në shumën 151,939 lekë; viti 2007 - 143,711 lekë; viti 2008 - 16,090 lekë dhe viti 2014 - 58,541 lekë.

⁶² Për më shumë referohuni në tabelën në pikën 17 analiza financiare të rezultateve të hetimit.

⁶³ Për më shumë shihni shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti në datën 7.7.2022.

Xh, si dhe nuk është konsideruar gjendja *cash* prej 800,000 lekësh e pretenduar nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe i vitit 2007 në vlerën 21,995 lekë.

	1997-2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Totali	Deklarata Vetting	2017
Pasuria	1,050,000.00	5,004,509.24	413,859.88	861,984.64	1,451,571.23	1,651,459.26	454,203.93	1,370,018.37	1,363,017.65	1,625,008.91	1,789,418.56	1,680,072.46	1,453,339.03	627,979.80	20,796,442.96	70,773.60	1,105,104.80
Automjet Volkswagen Golf	250,000.00														250,000.00		
Apartament 105 m2	0.00	5,703,300.00													5,703,300.00		
Automjet Mercedes benz	0.00						800,000.00								800,000.00		
Vend Parkimi 15.05.2014	0.00											500,000.00			500,000.00		
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>800,000.00</i>	<i>-698,790.76</i>	<i>413,859.88</i>	<i>861,984.64</i>	<i>1,451,571.23</i>	<i>1,651,459.26</i>	<i>-345,796.07</i>	<i>1,370,018.37</i>	<i>1,363,017.65</i>	<i>1,625,008.91</i>	<i>1,789,418.56</i>	<i>1,180,072.46</i>	<i>1,453,339.03</i>	<i>627,979.80</i>	<i>13,543,142.96</i>	<i>70,773.60</i>	<i>1,105,104.80</i>
<i>Total Likuiditeti</i>	<i>800,000.00</i>	<i>101,209.24</i>	<i>515,069.12</i>	<i>1,377,053.76</i>	<i>2,828,624.99</i>	<i>4,480,084.24</i>	<i>4,134,288.17</i>	<i>5,504,306.54</i>	<i>6,867,324.19</i>	<i>8,492,333.11</i>	<i>10,281,751.67</i>	<i>11,461,824.13</i>	<i>12,915,163.16</i>	<i>13,543,142.96</i>		<i>13,613,916.56</i>	<i>14,648,247.76</i>
<i>cash</i>	<i>800,000.00</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>	<i>900,000.00</i>	<i>700,000.00</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>	<i>0.00</i>			
Detyrime	0.00	2,995,170.38	-1,169,411.47	-518,141.15	-473,454.54	-484,048.10	-539,012.26	-225,260.87	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	-414,158.01	0.00	0.00
Kredia Bankare BIA 20,000 Eur ne 26.04.2004	0.00	2,534,800.00													2,534,800.00		
Shlyerje te kredise bankare	0.00	-300,069.62	-434,171.47	-518,141.15	-473,454.54	-484,048.10	-539,012.26	-225,260.87	0.00						-2,974,158.01		
Huaja nga E.M. ne mars 2004	0.00	1,267,400.00													1,267,400.00		
Pagese e huase ndaj E.M.Shlyer ne 2004 dhe 2005	0.00	-506,960.00	-735,240.00												-1,242,200.00		
Huaja nga Z. C.mars 2004 Borxhi eshte shlyer me kredine ne BIA	0.00	2,534,800.00													2,534,800.00		
Pagese e huase ndaj Z. C.	0.00	-2,534,800.00													-2,534,800.00		
Pasuria Neto	1,050,000.00	2,009,338.86	1,583,271.35	1,380,125.79	1,925,025.77	2,135,507.36	993,216.19	1,595,279.24	1,363,017.65	1,625,008.91	1,789,418.56	1,680,072.46	1,453,339.03	627,979.80	21,210,600.97	70,773.60	1,105,104.80
Te ardhura	5,054,636.00	2,273,265.39	2,247,712.00	2,313,970.75	2,839,027.32	3,884,780.67	3,003,253.56	3,180,877.51	3,431,029.65	2,895,261.00	3,063,670.80	3,053,069.57	2,829,338.09	2,589,134.24	42,659,026.54	342,973.78	2,480,991.20
Te ardhurat e Subjektit	2,460,727.00	762,071.00	773,602.00	1,208,151.75	1,441,043.75	1,362,808.67	1,301,404.24	967,706.00	930,267.00	952,245.00	1,328,834.53	1,190,462.00	1,102,810.00	1,142,508.00	16,924,640.94	91,334.25	1,096,011.00
Te ardhurat e b/shortes se SR	2,744,440.00	1,163,857.00	1,081,982.00	895,819.00	1,138,512.00	1,482,169.00	1,307,444.00	1,675,193.19	1,204,098.00	1,647,020.00	1,322,955.00	1,392,112.00	1,312,678.59	1,168,178.56	19,536,458.34	92,464.00	1,109,568.00
Te ardhura nga interesa Bankare nga Depozita	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	60,378.00	70,229.00	31,494.50	24,584.12	186,685.62		0.00
Te ardhura Dhurate nga prinderit (Prill 2004)	0.00	300,000.00													300,000.00		
Te ardhura nga interesa bankare nga Bono Thesari	0.00				64,000.00	146,121.00	165,400.00	231,000.00	344,400.00	275,038.00	241,158.00	290,000.00	286,000.00	159,174.56	2,202,291.56	159,175.53	182,347.20
Te ardhura nga shitja e automjetit Wolkswagen 27.04.2006	0.00			210,000.00											210,000.00		
Te ardhurat nga Honoraret	0.00	47,337.39	392,128.00	0.00	195,471.57	893,682.00	229,005.32	306,978.32	952,264.65	20,958.00	110,345.27	110,266.57	96,355.00	94,689.00	3,449,481.08		93,065.00
Shpenzime	2,824,846.41	473,134.68	519,833.40	351,495.38	935,996.61	1,407,525.68	789,206.55	932,219.44	1,060,940.54	957,607.31	1,024,794.54	1,367,508.34	1,299,835.24	1,444,409.40	15,389,353.50	79,351.35	1,374,521.50
Shpenzime Jetike	1,396,846.41	281,892.00	328,671.00	351,495.38	546,480.00	546,480.00	546,480.00	546,480.00	546,480.00	558,192.00	564,096.00	879,992.00	897,104.00	940,368.00	8,931,056.79	79,351.35	985,102.70
TIMS	0.00	0.00	95,581.20	0.00	315,761.51	325,201.80	183,743.45	280,243.84	230,945.54	378,457.31	400,408.24	441,280.04	350,424.24	236,206.80	3,238,253.96	0.00	389,418.79
Tims mbuluar nga honoraret		31,242.68	95,581.20	0.00	73,755.10	535,843.88	58,983.10	105,495.60	283,515.00	20,958.00	60,290.30	46,236.30	52,307.00	51,402.60	1,415,610.75		
Shpenzime Qiraje per banim	528,000.00	60,000.00													588,000.00		
Shpenzime per shkolim ne Shkollen e Mesme WAT (Montesori) Burse e plote	0.00													216,432.00	216,432.00		
Shpenzime mobilimi	900,000.00	100,000.00													1,000,000.00		
Mundesia per kursime	1,179,789.59	-209,208.15	144,607.25	582,349.59	-21,995.06	341,747.64	1,220,830.82	653,378.83	1,007,071.46	312,644.78	249,457.70	5,488.77	76,163.82	516,745.05	6,059,072.07	192,848.83	1,364.91

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

49. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën *Vetting* pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

49.1. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Albert Meça, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

49.2. Siç u evidentua edhe më sipër, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor në rezultatet financiare të viteve respektive.

49.3. Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklaratim dhe balanca negative e fondeve në vlerën 231,203 lekë (ose në vlerën 595,585 lekë nëse në analizë të ardhurat nga honoraret dhe dietat do të barazoheshin me shpenzimet e udhëtimit për arsye pune të subjektit dhe bashkëshortes së tij) nuk është e mjaftueshme që të pasjellë aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Të njëjtës logjikë i nënshtrohet edhe vlerësimi i pamundësisë kumulative ndër vite në shumën 231,203 lekë.

49.4. Për më tepër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se në asnjë rast pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

49.5. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklarimi i pasaktë i konstatuar si më sipër nuk duhet të ndikojë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël dhe mungesës së pasojave nuk cenohet figura e gjyqtarit dhe as besimi i publikut të drejtësia.

49.6. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Albert Meça, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLI I FIGURËS

50. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Albert Meça, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

50.1. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit raportin⁶⁴ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Albert Meça, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin

⁶⁴ Raporti nr. *** prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 26.5.2021, të KDZH-së.

e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

50.2. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit. Ky qëndrim nuk ka ndryshuar edhe pas përditësimit të raportit nga ana e DSIK-së.

50.3. Komisioni kreu një hetim⁶⁵ të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, z. Albert Meça, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, edhe pas përditësimit të informacionit, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

51. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Albert Meça, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

52. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

53. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

53.1. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

53.2. Raporti ka analizuar⁶⁶ të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

53.3. Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti nuk u konstatuan problematika.

53.4. Nga analizimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short subjektit iu kërkuan shpjegime vetëm për dosjen nr. 5.

⁶⁵ Shih dosjen me informacion të klasifikuar të subjektit të rivlerësimit

⁶⁶ Për më shumë referohuni tek rezultatet e hetimit.

Dosja 5 – çështja administrativo-penale nr. *** regj, datë 23.9.2013, që i përket kërkuetit F. T, me objekt “ankim kundër vendimit nr. *** të vitit 2013 të Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Tiranë për pushimin e procedimit penal”, e përfunduar me vendimin nr. s’ka, datë 18.12.2013.

Kjo kërkesë i ka kaluar për shqyrtim subjektit të rivlerësimit me shortin e datës 24.9.2013. Me vendimin e datës 2.10.2013 subjekti ka vendosur kalimin e çështjes në gjyq dhe ka caktuar seancën gjyqësore në datën 28.10.2013, ora 11:30. Për këtë çështje janë zhvilluar 5 seanca gjyqësore. Në seancën e datës 18.12.2013 gjykata ka shpallur: “*Rrëzimin e kërkesës së kërkuetit F. T, me objekt ‘ankim kundër vendimit për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2013 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë’, si të pabazuar në ligj*”.

Nga aktet në dosje rezulton se kundër këtij vendimi kërkueti ka paraqitur ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 20.10.2014, ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. *** akti, datë 18.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranimin e kërkesës.*”

*Prishjen e vendimit ‘Për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2013 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë’ dhe vazhdimin e hetimeve”.*

Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit Albert Meça në kryesekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 23.12.2013, 5 ditë pas shpalljes, brenda afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Albert Meça ka zgjatur gjithsej 2 muaj e 24 ditë, në intervalin kohor 24.9.2013 – 18.12.2013. Kjo kohëzgjatje është jashtë afatit standard 2-mujor të caktuar nga pika 5, germa “j” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar është i rregullt dhe aktet e krijuara apo të vlerësuara nga subjekti janë të sakta nga ana formale. Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga legjisllacioni procedural penal, sipas nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale.

Në përfundim të analizimit të këtij rasti, KLGJ-ja ka konkluduar se: (i) kohëzgjatja e gjykimit nuk e respekton standardin për një proces të rregullt ligjor, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së; (ii) procesverbali gjyqësor i administruar në dosje nuk është i plotë, me të gjitha përshkrimet për veprimet procedurale të kryera e sipas kërkesave të nenit 378/6 të Kodit të Procedurës Penale, pasi mungon vendimi për deklarimin të mbyllur të shqyrtimit gjyqësor të çështjes; (iii) në kundërshtim me parashikimin e nenit 379 të Kodit të Procedurës Penale “Menjëhershmeria e marrjes së vendimit”, ku parashikohet se “*Vendimi merret menjëherë pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor*”, subjekti ka vendosur shtyrjen e seancës gjyqësore pas 5 ditëve, me qëllim shpalljen e vendimit përfundimtar.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti prapësoi⁶⁷: “*Nga aktet që ndodhen në fashikull rezulton se kërkesa më është caktuar për shqyrtim me shortin e datës 24.9.2013, ndërsa fizikisht dosja është paraqitur në zyrën e gjyqtarit në datën 25.9.2013, sipas shënimeve përkatëse në regjistër dhe në kapakun e fashikullit. Brenda afatit 10 ditë, me vendimin e datës 2.10.2013, është vendosur kalimi i çështjes në gjyq, është caktuar seanca gjyqësore në datën 28.10.2013, ora 11:30, janë njoftuar palët në gjykim dhe janë marrë të gjitha masat e nevojshme organizative dhe administrative për zhvillimin e gjykimit. Për këtë çështje janë zhvilluar 5 seanca gjyqësore. Në seancën e datës 18.12.2013 gjykata ka vendosur: ‘Rrëzimin e kërkesës së kërkuetit F.T me objekt ‘ankim kundër vendimit për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2013 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë’, si të pabazuar në ligj’.*”

i. Në lidhje me kohëzgjatjen e gjykimit

Parashikimi i mësipërm i referohet gjykimit të çështjeve ‘pa palë kundërshtare’. Çështja objekt shqyrtimi nuk mund dhe nuk duhet të konsiderohet si e tillë, pasi qartësisht kërkueti F.T ka kundërshtuar vendimin e prokurorisë për pushimin e procedimit penal. Pra, pretendimet e kërkuetit dhe të prokurorit janë të kundërta, procesi është zhvilluar me debat midis palëve dhe

⁶⁷ Për më shumë shihni shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti në datën 7.7.2022

me ankim në Gjykatën e Apelit. Pra termi 'pa palë kundërshtare' në rastin konkret është i pabazuar dhe rrjedhimisht edhe referimi në pikën 5, shkronja 'j' e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit nuk është relevant më çështjen. Çështja nr. *** regj. them., datë 23.9.2013, që i përket kërkesës F.T, rezultoi se është gjykuar në harkun kohor 25.9.2013 – 18.12.2013. Gjatë kësaj periudhe kohore 3 ditë janë festa zyrtare (përkatësit 15.10.2013 Bajram dhe 28 - 29 Nëntor Dita e Pavarësisë dhe e Çlirimit). Çështja e mësipërme është gjykuar në 5 seanca gjyqësore dhe shkak i shtyrjes së seancave në asnjë rast nuk ka qenë për shkak të veprimeve apo mosveprimeve të gjyqtarit.

ii. Në lidhje me mungesën e vendimit për deklarimit të mbyllur të shqyrtimit gjyqësor sipas kërkesave të nenit 378 pg. 6 i Kodit të Procedurës Penale, vlerësoj se nuk mund dhe nuk duhet të trajtohet si shkelje apo mangësi. Neni 378 pg. 6 i Kodit të Procedurës Penale, në kohën e gjyqimit të çështjes, parashikonte se: 'Me mbarimin e diskutimit kryetari e deklaron të mbyllur shqyrtimin gjyqësor'. Gjykata, gjatë zhvillimit të një procesi gjyqësor, shprehet me urdhër ose me vendim, me qëllim garantimin e procesit, rregullimit e një situate të krijuar apo zgjidhjen e një pretendimi të palëve. Nocioni 'deklarim', i parashikuar nga neni 378 pg. 6 i Kodit të Procedurës Penale, i harmonizuar edhe me nenin 379 të Kodit të Procedurës Penale, është orientues dhe nuk sjell asnjë pasojë juridike. Në rrethin e profesionistëve prej kohësh diskutohej se parashikimi i mësipërm ishte joharmonik me nenet e tjera të Kodit të Procedurës Penale dhe krejtësisht i panevojshëm. Mendimi dhe qëndrimi i mësipërm tashmë është pasqyruar edhe në ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, 'Kodi i Procedurës Penale i Republikës Së Shqipërisë', të ndryshuar, në nenin 210 të tij ka parashikuar se: 'Në nenin 378, pikat 5 dhe 6 shfuqizohen''.

Komisioni, pasi vlerësoi prapësimet e subjektit, çmon se vonesa në gjykimin e çështjes gjyqësore, mungesa e pasqyrimit në procesverbal e vendimit për deklarimin e mbylljes së shqyrtimit gjyqësor, si dhe shtyrja e seancës për shpalljen e vendimit pas analizimit të përgjigjeve të subjektit nuk klasifikohen si mangësi profesionale. Komisioni vlerëson se edhe sikur hipotetiki këto të klasifikoheshin si mangësi profesionale ato nuk do të ishin të një shkalle për të cilën duhej të aplikoheshin neni 61/4 i ligjit nr. 84/2016.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-SË

54. Sipas të dhënave nga databaza e ankesave rezultoi se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit "8 tetor 2013 – 8 tetor 2016", për subjektin janë paraqitur gjithsej 2 ankesa (1 e vitit 2014 dhe 1 e vitit 2015) në Inspektoratin e ish-KLD-së.

Ankesa e vitit 2014 është arkivuar pas shqyrtimit paraprak, me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor në gjykatat më të larta.

Ankesa e vitit 2015, e verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, është vendosur në arkivim pasi nuk kanë rezultuar shkelje nga ana e gjyqtarit.

54.1. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezultoi që ndaj subjektit të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe as të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-KLD-ja.

54.2. Komisioni i ka dërguar shkresë Prokurorisë së Përgjithshme⁶⁸ dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor⁶⁹, të cilat kanë informuar si më poshtë vijon:

54.3. Në përgjigjen e saj, Prokuroria e Përgjithshme informon se për subjektin e rivlerësimit Albert Meça rezultoi e regjistruar ankesa nr. *** e vitit 2018, e shtetases M.K. Në kërkesën e saj kjo shtetase ankohet për veprimet e prokurorit të çështjes dhe dy gjyqtarë të shkallës së parë, për të cilët pretendon se kanë vendosur padrejtësisht dënimin me burg të bashkëshortit të

⁶⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 22.1.2020, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 22.5.2020, e Prokurorisë së Përgjithshme.

⁶⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 22.1.2020, drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 14.2.2020, e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

saj. Kjo ankesë rezulton të jetë arkivuar pasi nuk janë evidentuar të dhëna konkrete për veprime korruptive apo abuzive të subjektit të rivlerësimit.

54.4. Në përgjigjen e tij, Këshilli i Lartë Gjyqësor informon se për subjektin e rivlerësimit Albert Meça, në periudhën 1.1.2006 deri në datën e kthimit të përgjigjes, rezultojnë të regjistruara 6 ankesa. Pas verifikimit të këtyre ankesave KLGJ-ja ka vendosur arkivimin e tyre pasi nuk janë evidentuar rrethana që përbëjnë shkelje të disiplinës dhe të ligjit nga subjekti i rivlerësimit. Këshilli i Lartë Gjyqësor informon gjithashtu se për subjektin e rivlerësimit Albert Meça nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshill ndonjë masë për procedim disiplinor.

55. Denoncime

55.1. Për subjektin e rivlerësimit janë administruar 8 denoncime të paraqitura në Komision. Pas analizimit⁷⁰ të dokumentacionit të administruar rezulton se në të gjitha denoncimet nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga subjekti i rivlerësimit.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

56. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGJ-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

56.1. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

56.2. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti:

- i. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- iii. ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Albert Meça, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

⁷⁰ Për më tepër shihni rezultatet e hetimit administrativ.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
U shpall në Tiranë, në datën 18.7.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ

Kryesues

Pamela QIRKO

Anëtare

Genta TAFA (BUNGO)

Relatore

Sekretare gjyqësore

Etmonda Hoxha